

Tabela e përmbajtjes

1	Parathënie
2	Hyrje në doracak
5	Ushtrimet
6	1. Çfarë është monumenti për ty?
7	2. Pikëpamja ime, pikëpamje jote
10	3. Pantomima me monumente
11	4. Sfidat e ndërtimit të monumentit
13	5. Biografia e monumentit
14	Memory Walk udhëzues për lexim të monumenteve
15	6. Memory Walk filma të shkurtët
16	7. Një monument, dhjetë mendime
17	Kartela akterësh
19	8. Monumenti im ideal
20	9. Debatimi i monumenteve
21	10. Vizitë monumenteve lokale
22	11. Historia orale e monumentit
23	Tregimi i Memory Walk
23	Prapavija e konceptit
27	Shembulli i programit të Memory Walk
28	Video-komentet HIP
29	Sarajevë/Sarajevë lindore, Bosnje dhe Hercegovinë
33	Zagreb, Kroaci
36	Shkup, Maqedoni
39	Beograd, Serbi
43	Memory Walk Biblioteka
46	Mirënjohjet

Parathënie

Ky doracak është një prej materialeve kyçe të të mësuarit i zhvilluar si pjesë e projektit “Historia, Istorija, Povijest – Mësimet për të Sotmen”. Ky projekt ka filluar në vitin 2015 nga Anne Frane House, në bashkëpunim me organizatat partnere lokale nga Kroacia (Rrjeti kroat edukativ dhe zhvillimor për evoluimin e komunikimit – HERMES), Bosnja dhe Hercegovina (Iniciativa e të rinjëve për të drejtat e njeriut – YIRH dhe Humanizmi në veprim/Humanity in Action-HiA), Serbia (Komunikim i hapur/Open Communication – OK) dhe Maqedonia (Forumi Rinor Arsimitor/Младински образовен форум – MOF).

Kemi patur qëllime të mëdha – të rrisim ndërgjegjen dhe të inkurajojmë diskutimin mbi historinë jo të largët të nacionalizmit, përjashtimit, paragjyqimeve, diskriminimit në rajon dhe të promovojmë debate dhe dialog mbi të kaluarën e përbashkët. Gjithashtu kemi dashur të promovojmë të menduarit kritik mbi ngjarjet historike dhe relevancën e tyre për sfidat bashkëkohore, si dhe të inspirojmë mësimin e historisë të orientuar drejt dimensionit ndërdisiplinar dhe edukimit qytetar.

Projekti është i bazuar në misionin e Anne Frank House, një organizate e pavarur së cilës i është besuar kujdesi për vendin në të cilin Anne Frank është fshehur gjatë luftës së dytë botërore dhe ku e ka shkruar ditarin e vetë. Tani, organizata inkurajon reflektimin e rrezikut nga antisemitizmi, racizmi dhe diskriminimi dhe rëndësinë e lirisë, të drejtave të barabarta dhe demokracisë anembanë botës. Programi edukativ Memory Walk është i krijuar konform këtij misioni përmes përkrahjes së të rinjëve në përkujtimin e historisë së tyre, reflektimin mbi mënyrat në të cilat ajo është paraqitur përmes trashëgimisë dhe reagimin ndaj keqinterpretimeve dhe manipulimeve të mundshme të historisë dhe të kujtesës.

Ky doracak është i përcjellë me një DVD e cila ka trembëdhjetë filma të shkurtër të cilët janë krijuar nga nxënësit e shkollave të mesme nga Kroacia, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Maqedonia – të cilët shpresojmë që do të stimulojnë diskutime mbi historinë, kujtesën dhe të kujtuarit brenda dhe jashtë klasave të mësimit në tërë rajonin. Historia ka qenë për një periudhë shumë të gjatë faktor ndarjesh dhe mosmarrëveshesh në këtë rajon. Shpresojmë që kjo metodologji e diskutimit të hapur të pikëpamjeve dhe mendimeve të ndryshme të ju mundësojë të rinjëve të procesojnë këtë të kaluar në një mënyrë e cila do të krijojë hapësirë për të rimarrë të tanishmën, si dhe të ardhmen.

Ju dëshirojmë kohë të mrekullueshme mësimi gjatë përdorimit të këtij doracaku dhe DVD, dhe ndoshta edhe eksplorimin përmes Memory Walk të monumenteve në qytetet tuaja?

Dr. Maja Nenadović
Koordinatorë e programit edukativ të projektit 'Historia, Istorija, Povijest
– Mësimet për të tanishmën', Programet Edukative, Anne Frank House

Hyrje

Kemi nderin që të ju paraqesim Doracakun Memory Walk për edukatorë dhe mësime të cilët janë të përfshirë në diskutime mbi histori, trashëgimi dhe kujtesë me të rinjtë në formë inovative dhe përfshirëse. Ky doracak ofron materiale konkrete edukative mbi atë se si duhet të diskutohet për monumentet dhe se si të inkurajohen të rinjtë të analizojnë historitë (e kontestueshme). Ky doracak ka për qëllim të përdoret gjatë edukimit formal dhe joformal dhe është krijuar për të rinjtë e moshës 15 deri 20 vjeçare.

Gjenealogjia e Memory Walk

Që nga viti 2012, Anne Frank House ka qenë e përfshirë në zhvillimin e konceptit të Memory Walk në bashkëpunim me organizatat e saj partnere në tërë botën. Koncepti përmban punëtori për filma edukativ për të përkrahur pjesëmarrësit që të reflektojnë mbi kulturën publike të të kujtuarit. Në mes viteve 2012 dhe 2015, janë bërë më tepër se pesëdhjetë filma të shkurtër mbi monumentet, me dhe nga të rinjtë, duke përfshirë qindra pjesëmarrës ndërkombëtar.

Duke filluar si punëtori 3-5 ditësh mbi edukimin joformal, shpejt është bërë e qartë që ka ekzistuar nevoja për zhvillimin e materialeve mësimore që do t'ju mundësonin edhe mësime të cilët janë të përfshirë dhe edukatorëve të ofrojnë edukim joformal shpesh me më pak kohë në dispozicion, për të diskutuar për këto tema. Duke u ndërtuar mbi punën e organizatave tonë partnere nga Bosnja dhe Ukraina, ky doracak e bën metodën Memory Walk të përshtatshme për përdorim në klasë dhe gjatë organizimit të punëtorive të shkurtëra ose afatgjate.

Përse përqendrimi në monumente?

Monumetet shpesh herë parashihen të jenë për gjeneratën e ardhshme, dhe pikërisht janë të rinjtë ata të cilët shpesh anashkalohen gjatë marrjes së vendimeve, krijimin dhe ruajtjen e procesit të kujtesës. Në të njëjtën kohë, të rinjtë shpesh nuk ndjehen as të përgaditur e as të interesuar për këto kujtime të parashkruara të cilat duket që mirren vetëm me të kaluarën.

Punëtorja Memory Walk ka për qëllim të tregoj që monumentet na tregojnë po aq mbi çështjet e tanishme sa ne flasim për vuajtjet e së kaluarës. Ato na flasin për atë së kush jemi dhe prej nga kemi ardhur dhe na ndihmojnë të definojmë se çfarë konsiderohet të jetë e rëndësishme dhe çfarë më pak e rëndësishme për të kujtuar. Emrat e rrugëve, pllakat përkujtimore dhe monumentet mund të shpalosin histori të kontestueshme dhe raportin e pabarabartë të fuqive, kurse tregimet të cilat mungojnë në hapësirat publike kanë po aq për të thënë. Memory Walk ka potencial të informoj të rinjtë mbi ngjarjet kryesore historike dhe t'i aftësoj ata për të paraqitur pikëvështrimin e tyre mbi ideologjitë dominuese dhe tregime e monumeteve (që mungojnë). Përmes ushtrimeve kreative, kritike dhe inovative ata jo vetëm që do të rrisin vetëdijën e tyre mbi çështjet historike dhe ndërkulturore apo mbi shkathtësitë digjitale dhe sociale. Ata gjithashtu do të mësojnë mbi përgjegjësitë e tyre dhe rolin që e kanë përta i përket memorializimit.

“Memory Walk zgjeron njohurinë që nxënësit tanë e fitojnë gjatë mësimave të historisë. Ata mësojnë të shprehën në mënyrë kreative dhe mësojnë që ekzistojnë perspektiva të ndryshme mbi temën e njëjtë. Dhe më pas varet nga ta se çfarë do të zgjedhin”

(citim nga mësimpldhënësi kroat nxënësit e të cilit kanë marrë pjesë në Memory Walk)

“Ju na keni dhënë informacione të cilat programi mësimor i historisë nuk ka arritur të na jap.”

(citim i pjesëmarrësit të Memory Walk nga Bosnja dhe Hercegovina)

Struktura e doracakut

Thelbi i përmbajtjes së këtij doracaku përqendrohet në ushtrime, të përshtatura për përdorim në klasë (45-90 minuta). Kjo pjesë është e ndarë në mes të ushtrimeve hyrëse (siç janë “çfarë është monumenti për ju?”), ushtrimeve nga pjesa kryesore (siç është “Biografia e monumentit”) dhe ushtrimeve për detyrë shtëpie (siç është “Vizita e monumenteve lokale”).

Kjo ndarje ju ndihmon që të fokusoheni qoftë në paraqitjen e historisë, estetikën e monumenteve, interpretime të ndryshme të monumenteve nga njerëzit e thjeshtë dhe historitë (gojore) lokale.

Të marra së bashku, këto ushtrime përbëjnë një punëtori Memory Walk 5 ditore të kompletuar, por ushtrimet mund të bëhen edhe ndaras. Të bashkangjitur mund të gjeni një shembull të programit për tërë punëtorinë e Memory Walk i cili përbëhet nga përshkrimi i qëllimeve dhe reagimet e mësimitdhënësve dhe edukatorëve dhe ofron mundësi që të

- (1) fitohet një pasqyrë më e gjërë e punëtorive të Memory Walk dhe
- (2) ofrimin e tërë punëtorisë vetë me pjesëmarrësit, si pjesë e programit të shkëmbimit ose atij jashtëmësor.

Doracaku përfundon me një pasqyrë të caktuar të faqeve të internetit dhe burimeve që mund të ndihmojnë në thellimin e të kuptuarit të proceseve të të mësuarit të memorializimit. Kjo përzgjedhje përfshin burime në gjuhën angleze dhe gjuhët lokale të projektit HiP, por patjetër që nuk është gjithëpërfshirës dhe ne e inkurajojmë secilin përdorues që të kërkoj materiale shtesë mbi monumentet sipas përzgjedhjes së tyre.

I tërë doracaku, përfshirë edhe informacionet shtesë shpjeguese, mund të gjindet në faqen e internetit të HIP (shiko librarinë). Në Bibliotekën Memory Walk të këtij doracaku (faqe 43) mund të gjinden më tepër burime të informacionit.

Ushtrimet

Ky doracak përbëhet nga tre lloj ushtrimesh:

Hyrje

Përmbajtja kryesore

Detyrat e shtëpisë

Marrë së bashku këto ushtrime paraqesin shumicën e dy ditëve të para të tërë punëtorisë Memory Walk të filmit, por ato gjithashtu mund të mësohen të ndara.

Shumë prej ushtrimeve kërkojnë shembuj të monumenteve për t'u ilustruar në ushtrime. Mund të zgjidhni qoftë njërin prej filmave të shkurtër të Memory Walk që janë në dispozicion si burim (shih librarinë), përdorni burimet në Bibilotekën e doracakut (faqe 43) ose përdorni monumentet nga rrethi i juaj vendor.

Për arsye të lidhjes logjike në doracak i referohemi si 'mësimdhënës' atyre që janë përgjegjës për ushtrimet dhe si 'pjesëmarrës' atyre që marrin pjesë në ushtrime. Këto ushtrime nuk janë të kufizuara për t'u përdorur vetëm në mjedise të edukimit formal dhe mund të përdoren nga edukatorët dhe në edukim joformal.



Ushtrimi 1: Çfarë është monumenti për ju?

Hyrje

Qëllimi

1. Mësuesit mund të vlerësojnë nivelin e njohurive të pjesëmarrëses/it mbi temën e monumenteve dhe të memorializimit;
2. Pjesëmarrësit mund të formulojnë dhe reflektojnë mbi asociimet e tyre të para mbi fjalën 'monument';
3. Njohja e mëhershme e pjesëmarrësve mbi monumentet aktivizohet.

Formati

Diskutime, puna në çifte

Materialet

Letra ngjitëse, tabelë dhe lapsa

Koha

rreth 15-20 minuta

Hapat

1. Shkruani fjalën 'monument' në mes të fletës së flipchartit. Ndani pjesëmarrësit në çifte dhe jepni secilit çift një apo dy shënime në letra ngjitëse.
2. Kërkoni nga pjesëmarrësit që të mendojnë me partnerët e tyre për një minutë apo dy mbi pyetjen: 'Çfarë do të thotë monumenti për ju?' Theksoni që çdo asociim është valid, pra për shembull një ndjenjë, një fjalë, mendim, ngjarje, person dhe kështu me radhë. Pjesëmarrëset/it duhet të shkruajn gjënë e cila i asocion me një apo dy fjalë në letrën ngjitëse.
3. Pas disa minutash, kërkoni nga njëri prej pjesëmarrësve që të mbledh letrat. Ajo/ai më pas mund t'i vendos ato rreth fjalës 'monument' në fletën e flipchartit. Pyesni atë që të lexoj shënimet me zë.
4. Pyesni grupin lidhur me ngjashmëritë apo dallimet të cilat i vërejnë. Përderisa të diskutoni mbi konkluzionet e pjesëmarrësve, provoni të ndani asociimet sipas temave të cilat do të diskutohen më vonë në punëtori: 'historia & kujtesa kundrejt së tanishmës', 'emocionet kundrejt ngjarjeve historike' dhe 'estetika kundrejt mesazheve dhe përjetimit'.

Shtesë

Si hyrje në këtë ushtrim, mësimmhënësit mund të dëshirojnë të hapin diskutimin me pjesëmarrësit mbi atë së me cilin apo me çfarë lloj ushtrimi janë të njohur. Kjo mund të ndahet në **ushtrimin 1** për të lehtësuar futjen në temë dhe dinamikën e dhënies së ideve brenda kontekstit të tërë punëtorisë. Shpalosja e ideve mbi 'monumentet' mund të jetë hap i parë shumë i madh për pjesëmarrësit. Kjo ju mundëson mësimmhënësve që të ndihmojnë në definimin e asaj se çfarë është dhe çfarë nuk është një monument.

Ushtrimi 2: Pikëpamja ime, pikëpamja jote

Hyrje

Qëllimi

1. Pjesëmarrësit mund të reflektojnë në nivel bazik mbi qëndrimin e tyre në raport me monumentet dhe historitë që lidhen me to (p.sh. empatia historike);
2. Pjesëmarrësit mund të reflektojnë në nivel bazik mbi pikëpamjet e tyre personal dhe njohuritë për çështjet dhe/ose monumentet e caktuara.

Formati

Puna në grupe dhe prezantimet

Materialet


Lapsa dhe letra

Koha

Rreth 30-35 minuta

Hapat

1. Zgjidhni paraprakisht një apo është e preferueshme edhe dy monumente për t'i përdorur në këtë ushtrim (shihni shembullin poshtë). Këto monumente duhet të mundësojnë interpretime të ndryshme të cilat mund të jenë ose mos jenë në kundërshtim njëri me tjetrin.
2. Nëse përzgjidhni më shumë se një monument, ndane grupin dhe/ose monumentet konform kësaj. Paraqisni monumentet në mënyrë sa më koncize që të jetë e mundur. Jepni secilit pjesëmarrës një fletë letre dhe kërkoni nga ta që të vizatojnë një hartë mendore (shihni **Pamjen 1** më poshtë) me emrin e monumentit si pikënisje qendrore.



Pamja 1. Harta mendore mbi atë se si të krijohet harta mendore.

Burimi: en.wikipedia.org

Fjala kyçe: 'mind map' (harta mendore)

Pjesëmarrësit duhet të shtojnë pikëpamjet e tyre personale, mendimet, ndjenjat, idetë dhe

njohuritë mbi monumentet. Ajo çfarë ato/ata shtojnë në hartën e tyre mendore nuk duhet që patjetër të jetë faktike, të vërteta apo të sakta.

3. Kur pjesëmarrësit të jenë duke përfunduar hartën e tyre mendore, ndane grupin në grupe më të vogla prej jo më shumë se katër pjesëmarrës. Këto grupe më të vogla diskutojnë mes veti mbi hartat e tyre personale mendore. Nëse keni zgjedhur më tepër se një monument, ju lutem sigurohuni që të gjithë monumentet e ndryshme të jenë të paraqitur brenda grupeve më të vogla. Kërkonte nga pjesëmarrësit që të përqëndrojnë diskutimin e tyre në ngjashmëritë dhe dallimet në mes të hartave të tyre mendore.
4. Pas diskutimit të hartave mendore në grupe më të vogla, kërkonte nga një pjesëmarrës që të prezantoj rezultatet e tyre para tërë klasës. Me tërë grupin reflektoni mbi rezultatet e diskutimeve dhe provoni të futeni më thellë në shpjegimin e dallimeve dhe ngjashmërive. Mendoni për arsyet siç janë distanca gjeografike dhe/ose distanca kohore në raport me temën dhe/ose interesat e ndryshme. Më saktësisht, mësimdhënësit mund t'i shtrojnë pyetje pjesëmarrësve mbi atë se sa "jemi" në gjendje që të lëvizemi personalisht me historitë dhe me njerëzit të cilët kanë të bëjnë me këto monumente.

Shembull¹



Pamja 1. J. G. Wertheim, *Monumentit i mirënjohjes hebreje* (Amsterdam 1950).

Burimi: <http://en.tracesofwar.com/article/7608/Memorial-Jewish-Gratitude.htm>

¹Ky shembull shërben për ilustrim të këtij ushtrimi, por mund të zëvendësohet lehtë me çfardo monumenti të cilido konflikt ose regjion gjeografik.

Ky monument është një shembull i monumentit të kontestueshëm në kontekst të Hollandës. *Monumenti i mirënjohjes hebreje* i është dhuruar qytetit nga ana e Komunitetit hebrej të Amsterdimit si shenjë falenderimi për ndihmën (p.sh. strehimin) të cilën populli hebrej e ka marrë nga qytetarët e Amsterdimit gjatë luftës së dytë botërore.

Gjatë zbulimit të tij, monumenti ka qëndruar në një lokacion relativisht të shquar. Pas disa vitesh, monumenti është larguar nga vendndodhje e tij fillestare në sheshin kryesor në një vend në të cilin është relativisht e vështirë për ta vërejtur në një rrugë me lëvizje të shumta.

Ka patur arsye praktike për lëvizjen e tij, por ka patur edhe argumente më të mëdha historike për zhvendosjen e tij.

Kërkimet historike dhe publikimet e tregimeve të dëshmitarëve okular kanë shkaktuar ndryshimin e imazhit të Hollandës gjatë viteve 90-të. Para kësaj kohe, është besuar në përgjithësi që popullsia jo hebreje hollandeze ka qenë pothuajse në tërësi e përfshirë në rezistencë gjatë luftës së dytë botërore. Gjatë viteve të 90-ta, megjithatë është bërë e qartë që shumë jo-hebrej hollandez kishin bashkëpunuar me okupatorët nazist në dorëzimin e qytetarëve herbrenj. Për më tepër, ka patur shumë që kanë qëndruar anash të cilët kishin arsyet e veta dhe shpesh shumë të ndryshme për të mos rezistuar kundër okupatorëve (*lexoni më shumë mbi rolet e ndryshme të viktimave, ndihmësve, atyre që qëndruan anash dhe kryesve të krimeve në anefrank.org – fjala kyqe: 'bystanders' ose në shqip soditës*).

Ky monument prandaj, së pari është lidhur me ndjenjën e krenarisë kombëtare, kurse tani – i larguar, pa ndonjë pllakë zyrtare dhe pa mirëmbajtje të rregullt – është bërë simbol (mjaft i panjohur) i turpit.

Pra pyetja për këtë monument është: cilin interpretim do të zgjidhnit dhe për çfarë arsye?

Ushtrimi 3: Pantomima me monumente

Hyrje

Qëllimi	<ol style="list-style-type: none">1. Pjesëmarrësit janë rigjallëruar;2. Pjesëmarrësit lidhen me temën, sikurse edhe mes vete në mënyrë më të gjallë;
Formati	Grupe
Materialet	Lapsi dhe letra
Koha	Rreth 20 minuta
Hapat	<ol style="list-style-type: none">1. Këtij ushtrimi duhet ti qaset si një lojë të improvizuar. Pjesëmarrësit janë të ndarë në grupe prej dy deri në katër persona.2. Mësimdhënësja/si shkruan në copa të vogla të letrës detyrat e ndryshme lidhur me monumentet të cilat grupet duhet ti paraqesin/modelojnë. Këto detyra mund të jenë çdo gjë, duke filluar nga monumentet origjinale dhe kreative, deri tek ato ekzistuese: p.sh. Monumenti për dashurinë; Monumenti i marrëzisë njerëzore; Monumenti i fëmijërisë së lumtur; Monumenti i luftës dhe humbjes; Monumenti i turpit kombëtar; Monumenti i pakicave kombëtare; Monumenti i të drejtave të njeriut; Monumenti i fitores dhe triumfit, etj.3. Grupet e pjesëmarrësve kanë 5 minuta që të përcaktojnë pozitën e monumentin të tyre. Pastaj, do të krijojnë monumentin me trupat e tyre, përderisa pjesa tjetër e pjesëmarrësve duhet të ja qëllojnë se çfarë është ajo që ky monument tregon apo paraqet.4. Mund të jepen pikë për përgjigjen e saktë. Pasi që përfaqësimi apo tema e përgjithshme të jetë qëlluar saktë, grupi tjetër e paraqet monumentin e vetë e kështu me radhë.5. Në fund të ushtrimit mësimdhënësja/si moderon një diskutim të shkurtër mbi atë se përse nxënësit kanë zgjedhë këtë apo atë pozitë ose gjest. Në përgjithësi, çështja e subjektivitetit dhe perceptimit të monumenteve dhe interpretimit të tyre adresohet gjatë këtij diskutimi.

Ushtrimi 4: Sfidat e ndërtimit të monumentit

Përmbajtja thelbësore

- Qëllimi**
1. Pjesëmarrësit mund të përcaktojnë dhe emërtojnë mënyrat apo format tjera të kujtimit dhe komemorimit përveç monumenteve.
 2. Pjesëmarrësit mund të përcaktojnë dhe bëjnë dallimin në mes të atyre të cilët përkujtojnë dhe atyre që janë të përkujtuar.
 3. Pjesëmarrësit mund të indentifikojnë mesazhet dhe polemikat që fshihen pas monumenteve.
- Formati** Stil ligjerimi dhe/ose puna në grupe dhe prezantime
- Materialet** Prezantimet në PowerPoint (shkarkoni nga faqja e internetit të HIP), projektori, lapsa dhe letra
- Koha** Rreth 45-60 minuta
- Hapat** Ky ushtrim mund të bëhet në dy mënyra,
- 1) si një ligjerim i plotë duke përdorur prezantimet në PowerPoint, ose
 - 2) si ushtrim në grup.
- Ne do të përqendrohemi në ushtrimin e punës në grupe, duke besuar që ky shpjegim do të jetë i dobishëm për ata të cilët e përdorin Powerpointin.
1. Ofroni një shembull të një monumeti i cili ka qenë “në lajme” apo që ka rëndësi të madhe lokale. Përndryshe, një ligjerues mysafir mund të ftohet që të flas për monumentin apo mund të filloni duke i pyetur pjesëmarrësit nëse ju duket monument i rëndësishëm dhe të bënë këtë pikënisje.
Prezantoni monumentin duke ofruar disa të dhëna faktike:
Përse është ndërtuar?
Kush e ka inicuar dhe e ka ndërtuar?
Cili është projekti dhe vendndodhja e këtij monumenti?
A është kontestuar në ndonjë mënyrë?
Pasi që ky është vetëm një shembull i asaj se si mund të duket një monument, pjesëmarrësve ju kërkohet që të japin idetë e tyre alternative.
 2. Ndane grupin në pesë grupe më të vogla.
Çdo grup do të jap idetë e veta mbi njëriën prej temave.
Pasi që temat janë komplekse dhe abstrakte, mund të ndani letra me disa sugjerime të shkruara për të menduar si dhe foto të monumenteve të ndryshme. Secilit grup ja ofroni një fletë të madhe në të cilën mund të vendosin hartën mendore (shihni **ushtrimin 2**) apo të ilustrojnë idetë e tyre.

Grupi 1:

“Përse njerëzit ndërtojnë monumente dhe a është ky tregim për të kaluarën tani i rëndësishëm?”

Mendoni për arsyet e mundëshme (si psh impakti i luftës, humbja e anëtarëve të familjes, ndërtim i kombit) dhe rëndësia e monumenteve. A janë ato vetëm për të kaluarën ose edhe për të tashmen?

Grupi 2:

“Kush ndërton monumentet dhe me çfarë lloj mesazhi?”

Mendoni për politikanë, viktime/të mbijetuar, veteranë, artistë dhe aktivistë. Theksoni që këto role rallë herë janë të fiksuara dhe të thjeshta. Përsa i përket mesazheve mund të mendoni për vajtim/edukim/vërejtje/fajsim etj.

Grupi 3:

“Cilët aktorë tjerë janë të rëndësishëm për realizimin e monumentit?”

Mendoni për finansuesit, qeverisjen lokale, artistin/in dhe/ose arkitektin/in.

Grupi 4:

“Cilat forma tjera ekzistojnë për të përkujtuar luftën apo konfliktin?”

Mendoni për varreza, ndërtesa të dëmtuara por edhe tekste të historisë, filma, muze, libra dhe tregime familjare.

Grupi 5:

“Çfarë dallimesh në dizajn dhe vendngjarje mund të ketë dhe çfarë do të thotë kjo?”

Mendoni për dallimin në mes të dizajnit abstrakt dhe figurativ & vendodhjes autentike dhe simbolike. Gjithashtu keni vëmendjen në shenjat e shkatërrimit.

Grupi 6:

“Përse dhe si mund të kontestohen disa monumente? ose: Pse është ndërtimi i monumenteve ndonjëherë i vështirë?”

Mendoni për emocionet, përjetimet dhe përvojat e luftës të cilat mund t'i kenë njerëzit. Gjithashtu është me rëndësi që të diskutohet për disa aktorë të caktuar të cilët mund të kenë interes për të treguar (ose mohuar) tregimet të cilat i paraqesin monumentet (siç janë për shembull politikanët) dhe se si rezultat i kësaj mund të ketë monumente që “mungojnë” të cilat asnjëherë nuk do të vendosen.

3. Lerëni secilin grup t'i paraqesë rezultatet e diskutimeve dhe të diskutojnë mbi rezultatet e tyre në sesionin e gjerë. Përdorni PowerPoint për të ilustruar disanga temat.

Ushtrimi 5: Biografia e monumentit

Përmbajtja thelbësore

- Qëllimi**
1. Pjesëmarrësit mund të analizojnë një monument sipas estetikës së tij, historisë të cilën e paraqet dhe mesazhit të tij duke përcjellë udhëzuesin e leximit i cili është dhënë.
 2. Pjesëmarrësit mund t'ju prezantojnë analizat e tyre kolegëve të tyre në formatin të cilin ata do të përzgjedhin përmes dhënies së përgjigjeve në pyetjet në lidhje me gjërat e reja të mësuara, si dhe ngjashmëritë dhe dallimet në lidhje me monumentin 'e tyre'.
 3. Pjesëmarrësit mund të kuptojnë se procesi i memorializimit është universal, por se secili monument është pjesë e një konteksti specifik historik ose politik.
- Formati** Puna në grupe dhe prezantimet
- Materialet** Fleta të zbazëta, lapsa me ngjyra, lapsa dhe/ose materiale tjera për punë. Varësisht nga disponueshmëria, për burim të materialeve pjesëmarrësit mund të përdorin internetin ose për shembull artikuj të gazetave të cilët do të ndahen nga ana e mësimdhënësës/it.
- Koha** Rreth 60-120 minuta
- Hapat**
1. Përzgjidhni tre deri në pesë monumente të cilët do të paraqiten gjatë tërë punës së punëtorisë së Memory Walk. Pjesëmarrësit krijojnë grupe nga rreth pesë persona.
 2. Pjesëmarrësit do të bëjnë kërkime për monumentet e tyre duke përdorur udhëzuesin për lexim të Memory Walk (shihni më poshtë). Përqendrohuni posaçërisht në krahasimin e dallimeve dhe ngjashmërive në mes të monumenteve (kombëtare dhe të huaja).
 3. Pjesëmarrësit bëjnë prezantimin (në çfarëdo forme) të monumentit të tyre në bazë të kërkimit të tyre. Përdorin informacionet që kanë gjetur duke përdorur udhëzuesin e leximit dhe i drejtojnë prezantimet e tyre në dhënie e përgjigjes apo në adresimin e temave vijuese.
 - a. Çfarë gjërash të reja keni mësuar për monumentet? Çfarë keni mësuar dhe çfarë nuk keni ditur më herët në lidhje me historinë e paraqitur?
 - b. Çfarë dallime (ndër)kombëtare keni zbuluar në mes të monumentit tuaj dhe komuneteve tjera më të cilat është krahasuar?
 - c. Çfarë ngjashmëri (ndër)kombëtare keni gjetur tek monumentet e krahasuara.
 4. Pjesëmarrësit paraqesin monumentit e tyre. Publiku mendon për pyetjet që do ju bëjnë prezantuesve. Tentoni të adresoni estetikën, mesazhin e monumentit, dallimet dhe ngjashmëritë gjatë diskutimit vijues.

Udhëzuesi i leximit i Memory Walk

A. Historia

1. Cila ngjarje historike apo cili personazh historik është paraqitur? Si mund të vërehet kjo?

B. Ndërtimi

2. Kush e ka iniciuar monumentin?
3. Si ka ecur procesi i vendimarrjes?
4. Kur është ndërtuar monumenti?
5. Në cilin kontekst (social, ekonomik dhe/ose politik) është ndëruar monumenti?
6. Kush ka paguar për monumentin?
7. Kur, si dhe nga kush është inauguruar monumenti?

C. Funksioni

8. Ku ndodhet monumenti? Për shembull a është në një vend autentik ose në një simbolik, të fshehur apo në lokacion kyç...
9. Çfarë forme ose dizajni ka monumenti?
Për shembull apstrakt ose figurativ, tradicional ose modern...
10. Çfarë simbolesh (nuk)përdor monumenti? Për shembull ato religjioze, politike, gjinore, klasore, racore, historike, artistike, emocionale...
11. A ka ndonjë shkrim, shenjë apo pllakë? Çfarë (nuk) thotë ajo?
12. A ka mesazhe (bazike) për lexuesin? Për shembull përfshirëse ose përjashtuese apo mesazhe nderimi ose fajësimi ose mohimi ose edukimi...
13. Për kë ose kundër kujt është destinuar monumenti? Për shembull për viktimat, kryesit e krimin, asistuesit, ato që kanë qëndruar pa bërë gjë...
14. Cila është audiencia e cila është e synuar për monumentin dhe si e dijmë këtë? Për shembull gjuha(ët) lokale për njerëzit lokal, gjuha e huaj për turistët...
15. A ofron monumenti ndërveprim me vizitorët? Për shembull duke ju detyruar që të shikoni lartë/poshtë, të ecni përreth, ta prekni/mos e prekni...
16. Cili monument (lokal apo i huaj) ju bie ndërmend që mund të krahasohet me monumentin tuaj? Cilat janë dallimet? Cilat janë ngjashmëritë?
Si do t'i shpjegoni këto dallime dhe ngjashmëri?

D. Përgjigjet & pikëpamjet

17. A ka stimuluar apo stimulon monumeti ndonjë diskutim publik apo ndonjë polemikë? Kush është përfshirë në këto debate dhe përse? Cilat janë pikëpamjet dhe kritikak e ndryshme? Përse mendoni që e perceptojnë në mënyrë në të cilën e perceptojnë?
18. A ka ndryshuar gjatë kohës forma dhe/ose mesazhi i monumentit? Në çfarë mënyre?
19. Si duket monumenti sot? Për shembull a është i dëmtuar, ruajtur, lënë pas dore, i harruar apo bëhet kujdes i mirë për të...
20. A përdoret ende monumenti (zyrtarisht) gjatë përkujtimeve dhe/ose aktiviteteve tjera (politike)?
21. A është monumeti pjesë e përditshmërisë dhe a vizitohet? Nëse është kështu, në çfarë mënyre përdoret? Nëse jo, përse mendoni që është injoruar?

Ushtrimi 6: Filmat e shkurtër të Memory Walk

Përmbajtja thelbësore

Qëllimi

1. Pjesëmarrësit mund të kenë pikëpamje kritike ndaj filmave të shkurtër ekzistues të Memory Walk dhe të komunikojnë me bashkëmoshatarët e tyre.
2. Pjesëmarrësit mund të krijojnë një strukturë bazike të filmit të shkurtër Memory Walk dhe të përdorin tërë (ose pjesërisht) atë strukturë për krijimin e filmit të tyre.

Formati

Puna grupore dhe prezantimet

Materialet

Laptopët, lapsat dhe letra (p.sh. bllok shënimi)

Koha

Rreth 45-60 minuta

Hapat

1. Ndani grupin në pesë grupe më të vogla dhe mbani grupet të cilat janë ndarë për Ushtrimin 5 (shih faqen 13). Çdo grup do të bëjë hulumtime për një vend apo një rajon të caktuar për të cilin do të analizojnë filmat e shkurtër Memory Walk të cilët tashmë janë bërë.
2. Ndani një vend apo një rajon për secilin grup. Për të bërë këtë, vizitoni kanalën në YouTube të Anne Frank House në [youtube.com](https://www.youtube.com) – fjalët kyçe: 'anne frank house Memory Walk'. Bëne zgjidhjen që ju mundëson lidhjen e filmave të shkurtër, për shembull të atyre që mirren me tëmen e 'rezistencës'.
3. Secili grup e shikon filmin e shkurtër që i është përcaktuar dhe gjatë kësaj kohe hulumtojnë mbi historinë e cila është paraqitur në monument. Edhe një herë, ato mund t'i përdorin Udhëzimet për lexim, por në këtë ushtrim nuk është e domosdoshme që të përgjigjen në të gjitha pyetjet – vetëm në pyetjet në të cilat pjesëmarrësit mendojnë që mund të përgjigjen në bazë të filmave të shkurtër.
4. Tani pjesëmarrësit e shohin përsëri fimin e shkurtër, por këtë herë ata fokusohen në mendimet e ndryshme të cilat janë shfaqur në film. Në analizat e tyre, ata fokusohen në atë se si estetika dhe mesazhet e (perceptuara) të monumentit luajnë rol në opinionet e ndryshme.
5. Faza e kërkimeve tani mbaron dhe pjesëmarrësit fillojnë punën në prezantimet e rezultateve të tyre. Në prezantimet e tyre ata duhet të adresojnë të paktën njërën prej pyetje vijuese:
 - ⇒ Sipas jush, cili është kuptimi, qëllimi apo mesazhi i monumentit?
 - ⇒ Çfarë mund të thuani për dizajnin dhe vendodhjen e monumentit?
 - ⇒ Për cilat grupe apo cilët njerëz është krijuar monumenti?
 - ⇒ Me çfarë mendimesh të ndryshme janë ballafaquar në filmat e shkurtër? Cilat mendime apo pikëpamje nuk i keni dëgjuar apo parë? Mendoni për shembull për njerëzit të cilët janë më tepër drejtuar kah e ardhmja ose strategjitë e mohimit të njerëzve, siç janë politikanët të cilët tentojnë të fshehin ndonjë tregim të caktuar. Por mund të mendoni edhe për të rinjtë të cilët nuk ndihen të lidhur ose të preokupuar më këtë histori. Cila është pikëpamja juaj ose mendimi juaj për monumentin?
6. Grupet i prezantojnë rezultatet e tyre dhe përfundojnë me diskutim planar.

Ushtrimi 7: Një monument, dhjetë mendime

Përmbajtja thelbësore

- Qëllimi**
1. Pjesëmarrësit mund të identifikojnë dhe emërojnë aktorë të ndryshëm shoqëror dhe grupë të ndryshme të njerëzve të përfshirë në ndërtimin e monumenteve.
 2. Pjesëmarrësit mund të japin shpjegim bazik ose një tregim bazik të argumenteve të caktuara (kundërrthënese), arsytimeve dhe pikëvështrimeve që kanë të bëjnë me ndërtimin e monumenteve.

Formati Puna në grupe dhe prezantimet

Materialet Laptop, fleta të mëdha letre, lapsa me ngjyra, lapsa dhe materiale tjera për punën në fletë

Koha Rreth 45-60 minuta

Hapat

1. Printoni dhe pritni kartelat me role (shihni më poshtë ose shkarkoni këtu).
2. Edhe një herë, ndani grupin në grupe më të vogla nga 4-5 pjesëmarrës ose mbani grupet e krijuara për Ushtrimin 5.
3. Ndani secilin grup një film tjetër të shkurtër Memory Walk si burim inspirimi për monumentin dhe lejoni që grupet të diskutojnë mes veti mbi ngjarjet e caktuara historike me të cilat janë (deri diku) të njoftuar dhe për cilat do të dëshironin të bënin një monument. Për qëllim të këtij ushtrimi është jorelevante nëse një ngjarje specifike historike veçse ka monument apo jo.
4. Ndani kartelat me role spontanisht anëtarëve të grupit. Përdorni grupin e ri të kartelave për secilin grup. Jepni çdo grupi materiale me të cilat do të punojë.
5. Kërkoni nga pjesëmarrësit që së pari të përfshihen në diskutim në lidhje me monumentin në fjalë prej pozitës së rolit i cili ju është ndarë përmes kartelave të roleve. Pjesëmarrësit duhet të flasin nga pikëpamja e 'tyre'. Ata mund të jenë kreativ dhe të përdorin imagjinatën e tyre, por gjithashtu mund të përdorin opinionet e dëgjua në filmat e shkurtër Memory Walk.
 - ⇒ Cili është opinionin im (i rolit që luaj) në lidhje me këtë monument?
 - ⇒ Si e keni marrë idenë tuaj për këtë monument?
 - ⇒ Cila ka qenë arsyeja për përzgjedhjen e këtij monumenti?
 - ⇒ Çfarë përzgjedhjesh keni bërë dhe përse?
Cilat elemente nuk janë bërë pjesë e planit final?
 - ⇒ Ku do të ndërtohet monumenti?
 - ⇒ Cili do të jetë mesazhi i tij?
 - ⇒ Si do të financohet ndërtimi i tij?
 - ⇒ Si do të duket?
 - ⇒ Çfarë ceremonie do të ketë gjatë zbulimit të tij?
7. Secili grup e paraqet pllakatën e monumentit të vetë.

Kartelat e roleve²

QYTETARI

Ju vetë jeni dëshmitar i historisë e cila përkujtohet.

Mendoni për pozitën tuaj në lidhje me këtë monument. A keni qenë viktimë, dëshmitarë, qëndruar anash apo kryer aktin në këtë ngjarje historike? Apo keni patur role të shumëfishta?

Keni parasysh se kush apo çfarë jeni, për shembull grua ose burrë, e re apo e vjetër, pjesëtar i grupit shumicë apo pakicë (p.sh. grupit racor, etnik, LGBT) dhe çfarë orientimi politik keni.



VETERANI

Ju keni luftuar si ushtar profesionist gjatë ngjarjes historike e cila përkujtohet.

Mendoni se cila është pozita juaj në raport me këtë monument. Për kë apo ndoshta kundër kujt keni luftuar? A keni fituar apo humbur?

Keni parasysh se kush apo çfarë jeni, për shembull grua ose burrë, e re apo e vjetër, pjesëtar i grupit shumicë apo pakicë (p.sh. grupit racor, etnik, LGBT) dhe çfarë orientimi politik keni.



TURIST

Ju nuk jeni të njohur me historinë kombëtare e cila përkujtohet, por edhe ju keni monumentin tuaj për ngjarjen e njëjtë historike në vendin tuaj.

Imagjinoni se jeni duke parë monumentin për herë të parë. Çfarë do të mendoni për të? A do të dini menjëherë së cilën ngjarje historike e përkujton? Dhe çfarë nëse flasim për mëszahin e tij?

Keni parasysh se kush apo çfarë jeni, për shembull grua ose burrë, e re apo e vjetër, pjesëtar i grupit shumicë apo pakicë (p.sh. grupit racor, etnik, LGBT) dhe çfarë orientimi politik keni.



FQINJË

Ju jetoni menjëherë pranë vendngjarjes në të cilën është ndërtuar monumenti. Kjo do të thotë që do të ndesheni me këtë histori çdo ditë.

Mendoni për atë nëse pajtoheni me vendodhjen e monumentit? A do të dëshironit ta shihni çdo ditë? Çfarë mendoni në lidhje me pamjen e tij?

Keni parasysh se kush apo çfarë jeni, për shembull grua ose burrë, e re apo e vjetër, pjesëtar i grupit shumicë apo pakicë (p.sh. grupit racor, etnik, LGBT) dhe çfarë orientimi politik keni.



²Këto kartela me role nuk kanë për qëllim të kufizojnë pjesëmarrësit me një rol, por të shfaqin shumëllojshmërinë e roleve dhe përputhshmërinë e mundshme. Të keni parasysh se çdo etiketim, çdo rol dhe çdo aktor ka kompleksitetin e vet që duhet të diskutohet me kujdes.

AKTIVISTI

Ju jeni politikisht aktiv dhe dëshironi që diçka të bëhet me monumentin.



Mendoni nëse (dhe përse) dëshironi që ky monument të qëndrojë, të rrenohet apo të ndërtohet një tërësisht i ri.

Keni parasysh se kush apo çfarë jeni, për shembull grua ose burrë, e re apo e vjetër, pjesëtar i grupit shumicë apo pakicë (p.sh. grupit racor, etnik, LGBT) dhe çfarë orientimi politik keni.

ARTISTI apo ARKITEKTI

Ju jeni krijuesi i (vendodhjes së) monumentit



Mendoni për lidhjen tuaj personale që keni me monumentin apo nëse jeni tërësisht neutral? Çfarë do të jetë qëllimi apo synimi juaj më dizajnin tuaj?

Keni parasysh se kush apo çfarë jeni, për shembull grua ose burrë, e re apo e vjetër, pjesëtar i grupit shumicë apo pakicë (p.sh. grupit racor, etnik, LGBT) dhe çfarë orientimi politik keni.

PREFEKTI

Ju jeni prefekt i qytetit apo vendit në të cilin është ndërtuar monumenti.



Mendoni për të gjitha grupet e ndryshme të cilat i ndjekin qëllimet e veta me këtë monument. A mund të gjeni një ekuilibër në mes tyre apo e ndjekni drejtimin tuaj?

Keni parasysh se kush apo çfarë jeni, për shembull grua ose burrë, e re apo e vjetër, pjesëtar i grupit shumicë apo pakicë (p.sh. grupit racor, etnik, LGBT) dhe çfarë orientimi politik keni.

HISTORIANI

Ju jeni hulumtuesi akademik i historisë të cilën e përkujton monumenti.



Mendoni për atë se çfarë është më e rëndësishmja për ju si historian? A dëshironi saktësi historike dhe të vërtetën apo gjera të cilat janë më të dëshiruara nga shoqëria?

Keni parasysh se kush apo çfarë jeni, për shembull grua ose burrë, e re apo e vjetër, pjesëtar i grupit shumicë apo pakicë (p.sh. grupit racor, etnik, LGBT) dhe çfarë orientimi politik keni.

Ushtrimi 8: Monumenti im ideal

Përmbajtja thelbësore

- Qëllimi**
1. Pjesëmarrësit mund të përfshihen në mënyrë kreative në temën e monumenteve;
 2. Pjesëmarrësit janë në gjendje të shfaqin pikëpamjet e tyre në krijimin e rrëfimit alternativ;
 3. Pjesëmarrësit janë në gjendje të pasqyrojnë në nivel bazik në lidhje me përgjegjësinë dhe rolin e tyre në ndërtimin e monumentit.

Formati Puna individuale/grupore dhe prezantimet

Materialet Lapsa me ngjyra dhe pllakata (të mëdha) (argjili sipas dëshirës)

Koha Rreth 45-60 minuta

- Hapat**
1. I jepni çdo pjesëmarrësi një copë të madhe letra dhe/ose argjilë dhe ju kërkoni që të vizatojnë, të paraqesin hartën mendore, të ndërtojnë nga argjili apo të shkruajnë se si do të dukej monumenti i tyre ideal (nëse do t'i kishin të gjitha paratë e botës). Mund të bëhet fjalë për përmirësimin e një monumenti ekzistues apo ndërtimi të një të riu – varet nga ta se cilat ngjarje apo personalitete historike dëshirojnë të përkujtojnë.
 2. Vendosni të gjithë pllakatet në mur (ose vendosni modelet e bëra nga argjili në tavolinë) dhe krijoni një galeri pllakatesh/monumentesh. Inkurajoni pjesëmarrësit që të paraqesin punën e tyre para pjesës tjetër të grupit. Në prezantimin e tyre duhet të përgjigjen në pyetjet:
 - ⇒ Përse e keni përzgjedhur ngjarjen apo personalitetin e caktuar historik?
 - ⇒ Çfarë mesazhi dëshironi të përcillni me këtë monument?
 3. Pasi që të gjithë të kenë paraqitur momentin e tyre ideal, ju mund të drejtoni diskutimin me pyetjet vijuese:
 - ⇒ A mendoni që ju, si një person i ri, duhet të keni ndikim mbi atë së cilat monumente ndërtohen? Përse/përse jo?
 - ⇒ A kanë të rinjtë në përgjithësi ndonjë mendim në lidhje me monumentet? A duhet të kenë?
 4. Mund të përfundoni me diskutim mbi mënyrat në të cilat pjesëmarrësit mund të bëhen aktiv në mjedisin e tyre.

Ushtrimi 9: Diskutimi i monumenteve

Përmbajtja thelbësore

- Qëllimi**
1. Pjesëmarrësit ushtrojnë të menduarit e tyre kritik përmes debatit.
 2. Pjesëmarrësit i kuptojnë perspektivat e shumëfishta për një çështje të caktuar dhe janë në gjendje të japin argumente pro dhe kundër tyre, pa marrë parasysh pozitën ose mendimin e tyre personal mbi atë çështje.

Formati Format të ndryshme debatuese të përdoren me filma të shkurtër

Materialet Temat e debatit (shihni video komentet në faqe 28 për filmat e shkurtër në DVD dhe pyetjet e propozuar për debat)

Koha E ndryshme (forma të ndryshme debati, kohëzgjatje të ndryshme të ushtrimeve).

Sugjerim: përgatitja e grupeve të pjesëmarrësve = 10 minuta; paraqitja e argumenteve 1 minutë për fjalim (përafërsisht 10 minuta gjithsej); mësimdhënësi jep mendime apo përshtatje (3 minuta) = total, përafërsisht 20 minuta.

- Hapat**
1. Kërkoni nga pjesëmarrësit që të thonë nga një numër me zë. Pastaj ndajeni klasën, numra çiftë në njërën anë dhe numra tek në anën tjetër. I përcaktoni pozitën PRO dhe KONTRA secilës palë.
 2. Në grup duhet të gjejnë 3 argumente kryesore që paraqesin qëndrimin e tyre.
 3. Le të debatojnë mbi filmat e shkurtër të cilat posa i keni parë ose për ndonjë temë të ngjashme. Është me rëndësi për moderatorin që të gjithë t'i përmbahen roleve të veta, p.sh. të mbrojnë palën në të cilën janë (pa marrë parasysh mendimin e tyre). Ata do t'i paraqesin argumentet e veta sipas renditjes vijuese:
 - I. Argumenti 1 i grupit PRO
 - II. Grupi KONTRA i përgjigjet PRO1, ofron argumentin KONTRA1
 - III. Grupi PRO i përgjigjet argumentit KONTRA1, ofron argumentin PRO2
 - IV. Grupi KONTRA përgjigjet në PRO2, ofron argumentin KONTRA2
 - V. Grupi PRO i përgjigjet argumentit KONTRA2, ofron argumentin PRO3
 - VI. Grupi KONTRA përgjigjet në PRO3, ofron argumentin KONTRA3
 - VII. Grupi PRO e përmbledhë debatin duke argumentuar përse ka fituar
 - VIII. Grupi KONTRA e përmbledhë debatin duke argumentuar përse ka fituar

Ekstra

Përdorni një top të butë ose një lodër prej pelushi, me rregullin që 'vetëm personi i cili e ka në dorë topin mund të flasë' (përveç moderatorit). Hedhnjani topin grupit PRO, dhe kërkoni nga dikush që të ofroj një argument në favor të pozitës prej së cilës debatohet. Pas përfundimit, ata do të hedhin topin e butë tek dikush tjetër pa ndonjë renditje (ose nëse dikush dëshiron të flas, do të bëjnë me shenjë që e duan topin) në grupin KONTRA. Ata ofrojnë një argument apo përgjigje. Më pas përsëri ja hedhin topin dikujt në grupin PRO.

Hedhja e topin vazhdon përderisa përgjigjet dhe argumentet e ofruara të jenë të reja, p.sh. kjo është rregull – nuk mund të përsërisni diçka që veçse është thënë, por duhet të theksoni diçka të re, të ofroni argumente të reja. (Koha: jo më shumë se 15 minuta për çdo temë debati)

Ushtrimi 10: Vizita e monumenteve lokale

Detyra e shtëpisë

- Qëllimi**
1. Pjesëmarrësit janë të vetëdijshëm për ambientin e tyre lokal në përgjithësi dhe prezencën e monumenteve në veçanti;
 2. Pjesëmarrësit janë të përqendruar në temë dhe janë të njohur më temën në nivel bazik.
- Formati** Puna individuale/grupore dhe prezantimet
- Materialet** Kamera, laptop, lapsa, letër
- Koha** Detyra e shtëpisë: 90 min (kërkim)
Në klasë: 45 min (prezantimi)
- Hapat**
1. Kërkoni nga çdo pjesëmarrës që të gjejë monumentin më të afërt në rrethin e tyre dhe të bëjnë ndonjë hulumtim në lidhje me të (qoftë përmes interneti ose duke i pyetur prindërit/kujdestarët e tyre).
 2. Ata duhet të bëjnë foto dhe të gjenë diçka në internet që mund të përdorin dhe me çfarë të përgatisin prezentimin.
 3. Nxënësit i paraqesin monumentet e tyre (përmes programit për prezantim slide show osë pllakatit). Diskutimi mund të bëhet në lidhje me dallimet dhe ngjashmëritë të cilat i gjejnë në aspektin estetik, vendndodhje dhe mesazh.
- Ekstra** Ky ushtrim është gjithashtu i përshtatshëm si një ushtrim hyrës për t'i njoftuar pjesëmarrësit më mirë me temën dhe për të aktivizuar njohuritë e tyre të mëhershme.

Ushtrimi 11: Historia gojore e monumentit

Detyra e shtëpisë

- Qëllimi**
1. Pjesëmarrësit janë të vetëdijshëm dhe mund të ndërlidhen me tregimet personale në lidhje me monumentet;
 2. Pjesëmarrësit i ekspozohen mendimeve të njerëzve 'të rëndomtë' në lidhje me monumentet.
- Formati** Puna grupore dhe prezantimet
- Materialet** Laptop, telefona celular, kamera ose çfarëdo pajisje tjetër për xhirim
- Koha** Në klasë: 45 min (përgatitje) + 45 min (prezantim)
Detyrë shtëpie: 90 min (kërkim në shtëpi)
- Hapat**
1. Krijoni një listë të monumenteve të cilat pjesëmarrësit e kanë të lehtë t'i hulumtojnë. Ekzistojnë dy opsione për këtë ushtrim: (a) pjesëmarrësit vizitojnë në grupe monumentin dhe i intervistojnë kalimtarët në lidhje me kuptimin, mesazhin dhe mendimin e tyre për monumentin, (b) në çifte, pjesëmarrësit i intervistojnë dëshmitarët e rastit, arkitektin apo ndonjë aktor tjetër i cili ka të bëjë me ndonjë monument të caktuar.
 2. Gjatë prezantimit ata hulumtojnë në lidhje me monumentin (duke përdorur udhëzuesin e lexuesit shih faqen 14) dhe përgatisin pyetje (të hapura) në lidhje me monumentin për të cilin janë të interesuar.
 3. Për detyrë shtëpie, pjesëmarrësit e vizitojnë monumentin/ekspertin dhe xhirojnë (me telefon apo kamerë) intervistën(tat) e tyre. Ata duhet të inkurajohen që të bisedojnë me sa më tepër njerëz të ndryshëm. Posaçërisht në rrethana pas konflikti pjesëmarrësit duhet të përgatiten mirë për reagime (negative) më të cilat mund të ballafaqohen.
 4. Lëreni pjesëmarrësit që të përgatisin një multimedia prezantim në klasë dhe ta prezentojnë atë.
- Ekstra** Materiali i cili është mbledhë mund të përdoret për Ushtrimin 7: Një monument, dhjetë opinione (shih 16).

Tregimi i Memory Walk

Prapaskena e konceptit

Në mes të vitit 2012 dhe 2015, punëtorja e Memory Walk është mbajtur në 14 vende dhe janë krijuar gjithësej 50 filma të shkurtër. Kombinimi i formës së kërkimit të monumenteve duke përfshirë në mënyrë kreative pjesëmarrësit e rinjë në temë, është treguar si kombinim i suksesshëm.

Kjo nuk do të thotë, megjithatë, që koncepti është zhvilluar tanimë plotësisht. Në bazë të intervistave me ekspert, mësimdhënës dhe pjesëmarrës ne kemi përzgjedhur disa nga praktikat më të mira dhe pika të cilat është dashur t'i marrin parasysh. Këto deklarata janë dhënë nga disa prej njerëzve të cilët veçse kanë përvojë me punëtori. Me shpresë që kjo do të ofrojë një pamje të proceseve të të menduarit nëpër të cilët ka kaluar procesi i krijimit të Memory Walk.

Nëse dëshironi të jepni përgjigje ose të komentoni në ndonjërin prej koncepteve sipas përvojë suaj personale, ju lutemi na kontaktoni në **memorywalk@annefrank.nl** ose gjej email adresën e koordinatorit tuaj lokal ne faqen e internetit të HIP (shih librarinë)



Lidhja e së kaluarës më të tanishmën

'Punëtorja i jep pamjes dy dimensionale të historisë dimensionin e tretë të saj. Ajo i qaset monumenteve si skuta të fshehura të njohurisë historike, si një thesar urban i cili pret të zbulohet përderisa njëkohësisht edhe demistifikohet. Qëllimi i punëtorisë nuk është që të informohen kalimtarët mbi monumentin, por t'i tregohet pjesëmarrësve që historia është një debat i vazhdueshëm i cili bëhet në të tanishmën dhe jo një monolog i cili është gdhendur në gur.'

Tvrtko Pater, drejtor i HERMES dhe trajnues i Memory Walk, Kroaci

! Është me rëndësi të keni parasysh që pjesëmarrësit mund të jenë personalisht të lidhur me histori të caktuara. Çështjet të cilat diskutohen në ushtrime ndonjëherë mund të prekin plagë të dhimbshme, sidomos në vendet të cilat kanë kaluar nëpër luftë dhe konflikt para jo shumë kohe. Në këto rajone, e 'vërteta' mbi atë së çfarë ka ndodhë në të kaluarën mund të jetë temë e rëndë debati dhe këto debate mund të shfaqen (papratur) gjatë punëtorisë së Memory Walk.

Megjithatë, nuk janë vetëm ngjarjet e para jo shumë kohe për të cilat pjesëmarrësit mund të ndjehen të prekut. Kujtimet mund të jenë të ndjeshme, të shtypura apo të ruajtura në heshtje, qoftë edhe kur ngjarjet e kujtuara kanë ndodhur para më shumë se njëqind vjet më parë. Për disa mund të jetë e dimbshme bile edhe e pamundur që të flasin për këto gjëra. Një shembull i të kaluarës së tillë të 'vështirë' edhe pse të largët, edhe historia hollandeze me sklevër – histori e cila shpesh mohohet, nënvlerësohet apo qëllimisht 'harrohet'. Çelësi për mësimdhënësit është që çdo herë të jenë vigjilent për tensionet e mundshme brenda grupit, të vlerësojnë çdo pikëpamje dhe t'i trajtojnë të gjitha mendimet e ndjeshme të shprehura me respekt.

Ndërlidhja e vendeve

'Ushtrimet e Memory Walk ofrojnë mundësinë që të hulumtohet se si kryhet ndërtimi i monumenteve dhe se si kujtojmë. Punëtorja provon të zgjeroj kufijnjtë kombëtar përmes krahasimit të monumenteve nga e tërë bota. Punëtorja, prandaj, provon të ofroj një mënyrë për të parë përtej kufinjëve tanë dhe, edhe më tutje, përtej horizonteve tona historike.'

**Laura Boerhout, trajnuese e Memory Walk,
Anne Frank House dhe kandidatë për doktoraturë, Hollandë**



Vendimet që kanë të bëjnë me monumente shpesh mirren nga qeveritë kombëtare. Ato i shohin monumentet si mënyrë efikase për të treguar rrëfimin e kombit dhe për të krijuar ndjenjën kombëtare. Kjo është diçka që lehtë mund të kthehet në manipulim, gjë të njëanshme por edhe keqpërdorim të së kaluarës. Punëtorja Memory Walk provon t'ju ofroj pjesëmarrësve njohurinë dhe mjetet të cilat ju nevojiten për t'u bërë të vetëdijshëm për këto procese. Ata mësojnë se si ti krahasojnë monumentet e ndryshme lokale dhe kombëtare për të parë dallimet, por edhe për të parë ngjashmëritë në mes tyre. Kjo qasje komparative, megjithatë, përbën rrezik që të nenvlerësohet veçoria e secilit monument në vete. Qasja e balansuar është prandaj poashtu e rëndësishme.

Fitimi i aftësive praktike

'Është mirë që të shihen nxënësit të përfshirë në këto tema të cilat ndonjëherë janë të vështira. Kjo i sjell nga pozita pasive në pozitë të shqyrtimit dhe analizave kritike.'

Ines Lambert, Redaktore filmike, Kroaci



Duke e përfshirë bërjen e filmave si një prej komponentave kryesore të programit, historia vihet në dispozicion të së tanishmës. Pjesëmarrësit mësojnë se si ti shfaqin pikëpamjet e tyre. Kjo ju mundëson atyre që të përfshihen me tema komplekse dhe ju ndihmon të paraqesin tregime të cilat zakonisht janë të fiksuara të monumenteve në një formë më kreative.

Multiperspektiva e historive personale

“Multiperspektiva mund, nëse zbatohet siç duhet, të forcoj kualitetet potenciale dhe aftësitë e pjesëmarrësve. Ajo ndihmon që të kuptohet se si çdo pjesëmarrës mund të ketë pikëpamjen e vetë të së kaluarës lokale dhe të shoqërisë së tanishme. Përmes metodologjisë aktive të Memory Walk me intervistime dhe filmime, copa të gurit apo pejsazhit mund të vendosen në kontekst të duhur përmes hulumtimit dhe diskutimit.”

Senada Jusić, mësuese e historisë dhe trajnuese e EUROCLIO HIP, Bosnje dhe Hercegovinë



Të kërkohet nga ana e pjesëmarrësve që të jenë të hapur ndaj perspektivave të shumfishta mbi historinë do të thotë që edhe vetë duhet të jeni të hapur në lidhje me perspektivën dhe zgjedhjet tuaja si mësimdhënëse. Cilat monumente i përzgjidhni, cilat shembuj i përfshini dhe cilat i lini të papërfshira? Përse? Ekziston logjika prapa vendimeve tuaja, qoftë edhe ajo politike dhe ideologjike. Çdo perspektivë ofron mundësitë dhe kufizimet e veta dhe disa perspektiva mund edhe të jenë në kundërshtim njera me tjetrën. Proveni të jeni të sinqertë dhe transparent ndaj nxënësve në lidhje me preferencat dhe perspektivën tuaj, pasi që kjo mund të nxisë diskutim. Njëkohësisht, duhet të keni kujdes të mos lejoni që një perspektivë të nënvlerësoj tjetrën.

Fuqizimi i pjesëmarrësve

‘Ata dalin në publik, ata i shohin monumentet, ata flasin me njerëz dhe, në fund fare, ndihen të fuqizuar. Kjo është pasi që bëjnë punën, shtrojnë pyetje, ata janë krijuesit. Të jeni në gjendje të merrni rolin e gazetarit apo regjisorit të flimit – kjo është pjesa më interesante. Eksperimenti inkurajohet dhe dalja jashtë kornizave të përcaktuara nuk gjykohet.’

Ida Ljubić, mësuese e historisë, Kroaci



Një aspekt i rëndësishëm i ushtrimeve të Memory Walk është përqendrimi në rolin dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve. Kjo ju mundëson atyre që të paraqesin monumentet dhe historitë e tyre me fjalë të tyre. Një mënyrë për të shtyrë këtë është që të ju jepet pjesëmarrësve sa më tepër kontroll që është e mundur mbi materialin me të cilin punojnë: cilin monument dëshirojnë ta hulumtojnë ta hulumtojnë, kë dëshirojnë të intervistojnë dhe çfarë metoda dëshirojnë të përdorin për të paraqitur rezultatet e tyre.

Shembull i programit Memory Walk

DITA 1 Mësimet dhe të kujtuarit

Para se pjesëmarrësit të mund të fillojnë me aktivitetet e tyre kërkimore, ata do të marrin pjesë në ushtrime dhe do të dëgjojnë ligjerimet e aktorëve kryesor, siç janë ekspertët, artistët, aktivistët dhe dëshmitarët okular, dhe trajnuesit. Shihni ushtrimet në këtë doracak.

DITA 2 Vizita e monumenteve

Pjesëmarrësit vizitojnë monumente të ndryshme. Pikënisja për diskutimin e këtyre monumenteve është që pjesëmarrësit i qasen monumenteve sikurse të ishin hulumtues dhe/apo gazetarë. Ata do të vënë pikëpyetje monumentet dhe analizojnë kuptimin, estetikën dhe simbolizimin e monumentit.

DITA 3 Filmimi dhe kryerja e intervistave

Pasi të kenë bërë hulumtimin e tyre mbi një monument specifik pjesëmarrësit do të marrin një kamerë dhe kalojnë nëpër trajnim për intervistim. Pastaj, banorët e qytetit dhe kalimtarët e rastit intervistohen lidhur me perceptimet/mendimet/idetë/kritikat që kanë për monumentin përderisa xhirohen nga ana e pjesëmarrësve.

DITA 4 Redaktimi

Redaktimi i filmimit dhe krijimi i mini-dokumentarëve në kohëzgjatje prej pesë minutash nën udhëheqjen dhe asistencën e redaktuesve profesionist. Filmat e shkurtër paraqesin edhe historinë e treguar të monumenteve edhe mendimet e ndryshme të njerëzve të xhiruar.

DITA 5 Paraqitja dhe shpërndarja

Shfaqja e filmave dhe publikimi i filmave të shkurtër në YouTube në mënyrë që të arrihet një audiencë më e gjerë.

Video-komentet Memory Walk HIP

Punëtoritë e Filmit Memory Walk janë mbajtur në Bosnje dhe Hercegovinë (2013) dhe Kroaci, Maqedoni, Serbi (2014) si pjesë e projektit HIP.

Gjatë secilës punëtori të filmit MW, janë krijuar 3 filma të shkurtër prej nga 5 minuta në Sarajevë/Sarajevën lindore, Zagreb, Shkup dhe Beograd. Secili film i shkurtër merret me monumentin (e munguar) ose emrin e rrugës.

Më poshtë mund të gjeni shpjegimin e shkurtër të secilit monument, pyetjet për diskutim (të cilat mund t'i përdorni me ushtrimin për debat 9) dhe lexime shtesë/detyra të shtëpisë. Këto sugjerime për lexim përfshijnë referimet në gjuhët përkatëse (ANG & B/K/S & MAQ & SHQ). Kjo përzgjedhje në asnjë mënyrë nuk është e tëra dhe nuk i përgjigjet çdo herë mendimeve të autorëve, por ajo shërben në radhë të parë për inspirim dhe për të filluar diskutime.

Për burime më të përgjithshme dhe ato rajonale vizitoni bibliotekën e këtij doracak në faqen 43.

Çdo punëtori filma e Memory Walk ka krijuar 3 filma të shkurtër.

Filmi 1 ka të bëjë me monumentin nga lufta e dytë botërore,

Filmi 2 me monumentin nga koha e Jugosllavisë dhe

Filmi 3 me monumentin nga luftërat dhe konfliktet e viteve 90të (BiH, Kroaci, Serbi) dhe ndërtimin e kombit në 2010-tat (Maqedoni).



Sarajevë/Sarajevë lindore, Bosnje dhe Hercegovinë:

Filmi i shkurtër 1: Përmendorja e Millan Simoviçit

Çka paraqet ky monument?

Përmendorja e Millan Simoviçit, e vendosur në Palle – Sarajevë lindore, e përkujton partizanin Millan Simoviç: të ashtuquajturin hero të popullit të vlerësuar pas vitit 1945 në Republikën Federative Socialiste të Jugosllavisë. Urdhëri i Heroit të Popullit ka qenë vlerësimi i dytë më i lartë ushtarak për jugosllavët të cilët janë dalluar për vepra të posaçme. Ky status i është dhënë Simoviçit si udhëheqës i Çetës partizane të Kalorësve të Romanisë gjatë luftës së dytë botërore. Derisa ka qenë duke luftuar në linjën e frontit, ai e ka organizuar shkatërrimin e hekurudhës Sarajevë-Vishegrad. Ai ka arritur që ta vëjë jashtë përdorimit për më tepër së dhjetë muaj. Më vonë është vrarë nga Ustashat. Monumenti përbëhet nga përmendorja e Milan Simoviçit në një park të vogël.

Cilat kanë qenë dilemat apo kundërtëhëniet në lidhje me këtë monument?

Kujtimet nga lufta e dytë botërore vazhdojnë të vihen në pikëpyetje në Bosnje dhe Hercegovinë. Këto kujtime përsëri janë vënë në përdorim nga elita para viteve 1990të, duke rezultuar me perceptime kundërtëhënëse mbi lëvizjen partizane. Partizanët konsiderohen ose shtypës ose luftëtarë antifashist varësisht nga pikëpamje të ndryshme. Monumenti nuk luan më rol kryesor në kalendarin e përkujtimeve në Palle (Republika Serbe, BeH) kurse parku i vogël duket relativisht i lënë pas dore.

Pyetjet që sugjerohen për diskutim pas shikimit të videos së shkurtër

1. Përse disa njerëz janë shpallur “hero të popullit” gjatë Jugosllavisë?
2. Përse njerëzit mund të mos pajtohen me dhënien e statusit të heroit dikujt?
3. Përse janë luftëtarët dhe në masë më të vogël viktimat temë e monumenteve? A mund të ketë monument për ata që vetëm kanë vëzhguar dhe për shpëtuesit?
4. Çfarë ju tregon lënia pas dore e këtij monumenti (dhe ai i Filmit të shkurtër 2 të Parkut Memorial Vraça) lidhur me rëndësinë e luftës antifashtise (për grupet e ndryshme) në shoqëri?

Lexime shtesë/detyra të shtëpisë

1. Hulumtoni (ANG/BKS) Heronjtë e popullit dhe kërkoni ngjashmëri/dallime duke përdorur Listën e Dekorativave të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, 1945-1990
<http://www.medals.pl/you/you2.htm>
2. Lexoni më shumë(BKS) për Milan Simoviçin
“Milan Simović - od skretničara vozova do narodnog heroja”
www.palelive.com/licnosti/milan-simovic-od-skretnicara-vozova-do-narodnog-heroja

Filmi i shkurtër 2: Parku memorial Vraça

Çfarë paraqet monumenti?

Parku memorial Vraça është ndërtuar rreth vendodhjes së një forte auto-hungareze dhe është hapur në vitin 1981. Parku memorial Vraça përkujton viktimat partizane dhe ato civile të luftës së dytë botërore dhe ka patur funksion të rëndësishëm rekreativ gjatë ekzistencës së Jugosllavisë. Gjatë rrethimit të Sarajevës gjatë viteve të 90ta, parku është përdorur nga forcat ushtarake të serbëve të Bosnjës si një pikë strategjike e favorshme për të sulmuar qytetin i cili ndodhet poshtë në luginë. Këto forca gjithashtu pjesërisht e kanë shkatërruar parkun gjatë tërheqjes në vitin 1996. Në vitin 1995, Parku memorial Vraça është shpallur Monument kombëtar i Bosnjës dhe Hercegovinës. Mirëpo, deri më sot, parku mbetet i lënë në harresë.

Cilat kanë qenë dilemat ose cilat janë kundërtënie në lidhje me këtë monument?

Kujtimet nga lufta e dytë botërore vazhdojnë të vihen në pikëpyetje në Bosnje dhe Hercegovinë. Këto kujtime përsëri janë vënë në përdorim nga elita para viteve të 90-të, duke rezultuar në perceptime kundërtënie mbi lëvizjen partizane. Partizanët konsiderohen ose shtypës ose luftëtarë antifashist varësisht nga pikëpamje të ndryshme. Parku memorial Vraça prandaj edhe përveçohet edhe përjashtohet nga grupe të ndryshme në rajon. Parku memorial Vraça është vend posaçërisht i kontestuar duke marrë parasysh shtresat e shumëfishta të kujtimeve të cilat i bartë. Jo vetëm që sjellë kujtime nga lufta e dytë botërore dhe periudha e Jugosllavisë, ai gjithashtu ka luajtur rol tragjik gjatë rrethimit të Sarajevës. Dilema e tanishme ka të bëjë me rindërtimin e tij, gjë e cila ende nuk është vënë si prioritet edhe përkundër faktit që është në listën Kombëtare të monumenteve të mbrojtura. Disa OJQ në mënyrë aktive janë duke provuar që të pastrojnë zonën dhe të rikthejnë parkun.

Pyetjet e sugjeruara për diskutim pas shikimit të filmit të shkurtër

1. Para fillimit të rrethimit të Sarajevës në vitin 1992, aktivistë të ndryshëm kundër luftës e kanë quajtur veten sipas heroit të popullit Vlladimir Periq ("Valter") i cili e ka mbrojtur qytetin gjatë luftës së dytë botërore. Çfarë mendoni për qëllimin e riparaqitjes së "Valterit" në vitin 1992?
2. Nga të gjithë heronjtë e popullit, vetëm disa janë gra. Njëri prej monumenteve të Parkut memorial Vraça i përkushtohet Gruas luftëtare ("Žena-borac") duke paraqitur trimërinë dhe fitoren. Megjithatë, monumenti nuk është emërtuar sipas ndonjë heroine të caktuar të popullit. Krahasoni këtë me monumentin e Millan Simoviqit. Përse mendoni që ka dallim në mes të paraqitjes së heronjëve dhe të heroinave dhe çfarë na tregon kjo për statusin e tyre në Jugosllavi? A ka ndryshuar ai që nga atëherë?
3. Nëse parku memorial pastrohet dhe rindërtohet, çfarë funksioni duhet të ketë dhe a duhet të përkujtoj ndokënd apo ndonjë gjë?

Material shtesë/detyra të shtëpisë

1. Shikojeni (ANG/BKS) filmin Valteri e mbron Sarajevën ("Valter Brani Sarajevo") (1972) për njërin prej heronjëve të popullit i cili ka ndihmuar në mbrojtjen e Sarajevës gjatë luftës së dytë botërore.
2. Lexoni (BKS) nga Amra Čusto *Kolektivna memorija grada - Vječna vatra i Spomen Park Vraca*. Historijska traganja, 1, 2008, [str. 101-123]
http://www.iis.unsa.ba/pdf/historijska_traganja_1.pdf dhe lexoni (ANG) në lidhje me parkun memorial Vrača në faqen e internetit të Komisionit të monumenteve kombëtare
http://www.kons.gov.ba/main.php?id_struct=50&lang=4&action=view&id=2559
3. Lexoni (BKS) Gorana Mlinarević 2015. *Kako spasiti tekovine antifašizma i jednakosti svih? Simbolička intervencija i inicijativa za obnovu ruke "Ženi borcu" na Vracama*. 60-68. In: Baština. Muzej književnosti i pozorišne umjetnosti. Sarajevo, 2015.
4. Lexoni (ENG) Jasmina Čaušević (ed). *Women Documented, Women and Public Life in Bosnia and Herzegovina in the 20th Century*. Sarajevo, 2014
soc.ba/site/wp-content/uploads/2014/10/women-Documented_web-verzija-sa-koricama.pdf



Filmi i shkurtër 3: Trëndafilat e Sarajevës

Çfarë paraqet ky monument?

Trëndafilat e Sarajevës janë shenja konkrete të shkaktuara nga eksplodimi i predhave të mortajave të cilat më vonë janë mbushur me cement ngjyrë të kuqe. Ato i përkujtojnë njerëzit të cilët janë vrarë gjatë Rrethimit të Sarajevës (1992-1996). Kush ka filluar t'i mbushë kraterët me ngjyrë dhe kur nuk dihet, por gjatë viteve qytetarët dhe aktivistët kanë provuar t'i ruajnë dhe t'i theksojnë këto vende të kujtimit.

Cilat kanë qenë dilemat apo cilat janë kundërthëniet përsa i përket këtij monumenti?

Ekzistojnë disa tregime kundërshtuese mbi atë se kush e ka inicuar këtë monument dhe deri në këtë moment është e paqartë se kur dhe nga kush është krijuar monumenti. Monumenti është mbrojtur nga disa OJQ dhe deri në vitin 2012 qeverisë nuk i është bërë vonë që të përkujdeset për to (disa prej trëndafilave janë zhdukur pas rindërtimit të rrugëve). Në vitin 2012, qeveria ka filluar renovimin e disa prej këtyre trandafilave. *Trëndafilat e Sarajevës* janë anonime dhe të mbetur pa asnjë spjegim apo pllakë përkujtimore, që e bënë të mundshëm për to që të përkujtojnë të gjithë viktimat e luftës, përderisa, në të njëjtën kohë, shumë turistë kalojnë pranë tyre pa i vënë re fare. Për disa sarajevas ato paraqesin një kujtim të fortë të së kaluarës, përderisa për të tjerët shihen si shenjë e shkatërrimit të qytetit i cili duhet të rindërtohet.

Pyetjetet e sugjeruara për diskutim pas shikimit të filmit të shkurtër

1. A është me rëndësi të dihet iniciatori dhe përse po ose përse jo?
2. Përse qeveria në të kaluarën nuk ka patur aq shumë dëshirë për të mbrojtur monumentin?
3. Sa është i rëndësishëm roli i veprimit të qytetarëve kur të shihet ky monument?
4. Gjatë shekujve 19 dhe 20 shumica e monumenteve ka qenë përmendore të mëdha. Nga fundi i shekullit 20, një trend i ri i monumentit u shfaq që është pjesë e trotuarit, në të cilët duhet të ngecësh për t'i vërejtur. Përse është shfaqur ky trend i ri dhe çfarë dallimi në efekt ka statuja e madhe kundrejt një monumenti në tokë?
5. Sipas mendimit tuaj, a duhet të ketë ndonjë shpjegim apo tekst (p.sh. pllakë) të vendosur pranë monumentit apo duhet të lihet si një përkujtim i heshtur?

Materiale/detyra të shtëpisë shtesë

1. Lexoni (ANG/BKS) Sarajevske ruže ; Ka politici sjećanja - Azra Junuzović / Sarajevo roses ; Towards politics of remembering (ArmisPrint, Sarajevo ; 2006).
2. Lexoni (BKS) Youth activist actions in 2015: Bojom podsjetili na krv iz sarajevskih ruža <http://balkans.aljazeera.net/vijesti/foto-bojom-podsjetili-na-krv-iz-sarajevskih-ruza>
3. Krahaoni (ENG/BKS) Trëndafilat e Sarajevës me Stolpersteine/Gurët e ngecjes në tërë Europën ("Kamenovi Spoticanja") https://bs.wikipedia.org/wiki/Kamenovi_spoticanja

Filmi i shkurtër 1: Monumenti për viktimat e dhjetorit

Çfarë paraqet monumenti?

Filmi i shkurtër e analizon monumentin "Viktimat e dhjetorit" nga Dushan Xhamonja – historinë e cila e përcjellë monumentin dhe perceptimet e ndryshme të asaj historie. Monumenti i përkujton viktimat e varrjes publike në Zagreb të cilën e kanë bërë autoritetet kroate të shtetit marionetë nazist të NDH (Shteti i pavarur i Kroacisë). Gjashtëmbëdhjetë antifashistë janë varrur pa gjyq në dhjetor të vitit 1943 si hakmarrje për shkatërrimin e deposë së fshehtë të armatimit nga ana e partizanëve (lëvizje antifashiste gerile e cila ka vepruar në Kroaci në atë kohë).

Cilat kanë qenë dilemat ose cilat janë kundërtëhëniet që kanë të bëjnë me këtë monument?

Lufta e dytë botërore është ende temë e ndjeshme në Kroaci pasi që në atë kohë një pjesë e popullsisë ka bashkëpunuar me okupatorin nazist kurse tjetra ka luftuar kundër okupimit në lëvizjen partizane. Të dy palët kanë pësuar humbje dhe shumë janë ende të ndjeshëm për anëtarët e familjes të cilët i kanë humbur në luftë.

Pyetjet e sugjeruara për diskutim pas shikimit të filmit të shkurtër.

1. A është e mundur të krijohet një monument i cili tregon të gjitha anët e historisë komplekse? A duhet që monumenti të provojë të bëjë këtë?
2. Si është e mundur që disa njerëz nuk kanë ide se ku është monumenti apo çfarë paraqet ai?
3. A është shkatërrimi i depos së fshehur së shtetit marionetë nazist një akt terrorist apo rezistence?
4. Sipas mendimit tuaj, a është një monument abstrakt i përshtatshëm për të përkujtuar një ngjarje të tillë?
5. Sa është e rëndësishme për të përkujtuar antifashizmin?

Materiale shtesë për lexim/detyrë shtëpie

1. Lexoni (B/K/S) "Iz ilegalnog Zagreba" by Ivan Šibl.
2. Lexoni (B/K/S) shkrime nga nxënësit në përkujtimin e luftës së dytë botërore në Kroaci "Moj zavičaj kroz vrijeme" nga Documenta http://www.documenta.hr/assets/files/publikacije/Moj_zavicaj_kroz_vrijeme.pdf
3. Hulumtoni lëvizjen partizane në Jugosllavi, ose më konkretisht në Kroaci.
4. Hulumtoni (BKS) përkujtimin e kompleksit të kampit të përqendrimit nga lufta e dytë botërore Jasenovac <http://www.jusp-jasenovac.hr/Default.aspx?sid=6468> dhe lexoni (BKS) mbi arkitektin jugosllav të Jasenovcit http://www.slobodnaevropa.org/content/Bogdanovic_dokumentarni_film/2177961.html

Filmi i shkurtër 2: Emri i sheshit Marshall Tito

Çfarë paraqet monumenti?

Kjo video paraqet mendime të ndryshme që kanë të bëjnë me sheshin Marshall Tiro (Trg Maršala Tita). Ky është njëri prej shesheve kryesore të kryeqytetit të Kroacisë Zagreb dhe është emëruar sipas kreut të shtetit të ish shtetit komunist të Jugosllavisë. Kroacia është ndarë nga Jugosllavia gjatë luftës për pavarësi në vitet 90-të.

Cilat kanë qenë dilemat apo cilat janë kundërthëniet në lidhje me këtë monument?

Emri i sheshit është kontravers, pasi që trashëgimia e Titos shihet në mënyra të ndryshme në shoqëri. Një pjesë e njerëzve në periudhën post-jugosllave e shohin Titon si një burrështetas të madh i cili ka bërë shumë për vendin: gjatë luftës së dytë botërore kur e ka udhëhequr luftën kundër okupatorëve nazist dhe e ka rindërtuar Jugosllavinë më pas. Të tjerët e konsiderojnë Titon si një kriminel lufte dhe diktator edhe për shkak të trajtimit të të burgosurve të luftës pas përfundimit të luftës edhe për shkak të përndjekjes së kundërshtarëve politik gjatë kohës së paqës.

Pyetjet e sugjeruara për diskutim për shikimit të filmave të shkurtër

1. Deri në çfarë mase emri i rrugës apo sheshit mund të shërbejnë si monument? Çfarë rëndësie mund të ketë?
2. Si është e mundur që një figurë e tillë aq e rëndësishme historike të shihet në mënyra aq të ndryshme?
3. A është e mundur që ajo çfarë të dyja palët mendojnë është e vërtetë?
4. A është e mundur të mësohet historia nëse nuk ka marrëveshje të qartë mbi rrëfimet historike?
5. A mendoni që kjo diferencë është rezultat i sistemit arsimor dhe asaj çfarë njerëzit mësojnë në shtëpi? A i ka dhënë interneti më tepër qartësi temave të tilla të kontestuara historike? Përse?

Materialë shtesë për lexim/detyrë të shtëpisë

1. Shikoni (ANG/BKS) – pjesë të – filmin dokumentar të BBC-së “Vdekja e Jugosllavisë” në YouTube dhe diskutoni për të. <https://www.youtube.com/watch?v=oODjsoLoSYo>
2. Bëni hulumtim për ndonjë figurë politike dhe kërkoni perspektiva të ndryshme mbi jetën dhe punën e tyre (nga Fidel Castro deri tek Mahatma Gandhi).
3. A kanë bërë pjesëmarrësit kërkim për 'efektin Rashomon' i cili merret me interpretime kontradiktore të ngjarjeve të njëjta nga njerëz të ndryshëm. Përdorni artikullin (ANG & B/K/S & SHQ& MAQ) “Jugo-nostalgjia lulëzon tek memorali i Titos” për një hulumtim krahasues. <http://www.balkaninsight.com/en/article/yugo-nostalgia-thrives-at-tito-memorials>

Filmi i shkurtër 3: Monumenti për Aleksandra Zec?

Çfarë paraqet monumenti?

Filmi shtron pyetjen nëse duhet të ketë monument i cili e përkujton vdekjen e Aleksandra Zec. Aleksandra Zec ka qenë një vajze 12 vjeçe nga Zagrebi e cila është vrarë së bashku me babain dhe nënën e saj pasi që kanë qenë Serb etnik. Vrasjet janë bërë nga pjesëtarët e forcave rezervë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kroacisë; kryesisht asnjëherë nuk janë dënuar për këto vrasje.

Cilat kanë qenë dilemat apo cilat janë kundërthëniet në lidhje me këtë monument?

Kjo ngjarja nuk është diskutuar në masë të gjerë pasi që ballafaqimi me të do të thotë edhe ballafaqim me faktin që kroatët kanë kryer krime lufte. Ekziston një perceptim i gjerë tek shumë njerëz që të flitet për çfarëdo të keqeje që Kroacia ka bërë gjatë luftës e zhvlerëson faktin që vendi ka patur të drejtë të mbrojë pavarsinë e vetë nga agresioni.

Pyetjet e sugjeruara për diskutim pas shikimit të filmit të shkurtër

1. Përse disa njerëz e konsiderojnë etnicitetin, racën apo elgijonin e dikujt aq të rëndësishëm?
2. Përse është e vështirë për shoqëritë që të pranojnë që edhe grupet/ushtritë e tyre gjithashtu kanë bërë krime?
3. Cila është vlera e krijimit të monumenteve për viktimat e krimeve të cilat i kanë kryer bashkëkombasit tuaj?
4. A mendoni që monumentet e tilla mund të ndihmojnë në parandalimin e urrejtjes dhe shtypjes së pakicave në të ardhmen?

Materiale shtesë për lexim/detyra shtëpie

1. Shikoni (ANG/BKS) eseun e fotografive të Sandra Vitaliq për vendin ku është vrarë familja Zec. Neplodna tla' Sandre Vitaljić: Izložba s koje čete izaci na rubu suza ili potpuno ravnodušni <http://www.jutarnji.hr/-neplodna-tla--sandre-vitaljic--izlozba-s-koje-cete-izaci-na-rubu-suza-ili-potp-uno-ravnodusni/444667/> and https://www.academia.edu/3053923/INFERTILE_GROUNDS_THE_PHOTOGRAPH_AS_A_SITE_OF_MEMORY
2. Lexoni (ANG/BKS) "The Zec Family: A Memorial Still Awaited" <http://cdtp.org/wp-content/uploads/2014/05/RECOM-Initiative-Voice-13-2013-ENG.pdf> & <http://www.recom.link/bs/glas-inicijative-za-rekom-13-2013-2/>
3. Krahasoni tregimin e Aleksandra Zec me viktimat tjera fëmijë të luftës, siç janë Zlata Filipović (BeH) and Anne Frank (Hollandë) apo tregimin fiktiv të Liesel Meminger (Gjermani) në "The Book Thief" nga Markus Zusak.

Filmi i shkurtër 1: Monumenti Nevena Georgieva

Çfarë paraqet ky monument?

Filmi paraqet monumentin e Nevena Georgieva – Dunja, gruas së re partizane e cila është ekzekutuar në moshën shtatëmbëdhjetë vjeçare. Koka e saj është prerë dhe është vënë në shtyllë, dhe më vonë i është treguar njerëzve në Veles të Maqedonisë si mënyrë për t'i frikësuar. Ajo ka qenë shumë aktive në lëvizjen partizane në mes të dy luftërave botërore, megjithatë, për të ka shumë pak të dhëna.

Cilat kanë qenë dilemat dhe kundërthëniet në lidhje me këtë monument?

Ky monument ndodhet në parkun “Gruaja luftëtare” në Shkup, por pas projektit qeveritar të monumenteve “Shkupi 2014”, ky monument e ka humbur dukshmërinë e tij dhe pothuajse askush nuk e di që ekziston dhe kë paraqet. Monumenti është kontestuar pasi që paraqet mungesën e përfaqësimit gjinor (dhe të rinjëve) në monumente.

Pyetjet e sugjeruara për diskutim pas shikimit të filmit të shkurtër

1. Përse mendoni që luftëtarët gra janë më të përjashtuara nga kultura e kujtesës, në krahasim me monumentet e heronjëve meshkuj?
2. A janë paraqitur gratë dhe fëmijët e rëndësishëm mjaftueshëm në libra të historisë dhe në monumente? Çfarë mendoni që mungon?

Materiale shtesë për lexim/detyrë shtëpie

1. Krahasoni Dunjën (ANG) me luftëtarët tjerë partizane në rajon ose me luftëtarët tjerë në konflikte në mbarë botën <http://www.historynet.com/famous-women-in-history>
2. Përpos që janë luftëtare, gratë mund të kenë role tjera – në të njëjtën kohë – për shembull si viktime, kryese të krimit, vëzhguese pasive dhe shpëtuese. Gjeni për secilin prej këtyre roleve (të grave) një person në histori i cili i përgjigjet këtij etiketimi ose këtyre etiketimeve. A duhet edhe ato të kenë monument dhe si duhet të duket ai? Përdorni ushtrimin ‘Monumenti im ideal’ për të krijuar një monument dhe për të shpjeguar rëndësinë e tij.
3. Përdorni ushtrimin ‘Biografia e monumentit’ (faqe 13) për të hulumtuar monumentet e figurave tjera të grave, siç është monumenti i Nënës Terezë në Shkup nga Tome Serafimovski.

Filmi i shkurtër 2: Monumenti për Josip Broz Titon

Çfarë paraqet monumenti?

Filmi i shkurtër paraqet monumentin e Josip Broz Titos në kryeqytetin e Maqedonisë. Tito ka qenë president i Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë. Tre monumente në Shkup paraqesin Titon, dhe që të tre janë në të njëjtin vend, para shkollës së mesme e cila bartë emrin e tij.

Cilat kanë qenë dilemat apo cilat janë kundërtëhëniet në lidhje me këtë monument?

“Shkupi 2014”, projekt i cili ka përfshirë vendosjen e 34 monumenteve, nuk e ka përfshirë asnjë nga periudha jugosllave, kështu që partia e quajtur “Forcat e majta të Titos” ilegalisht kanë ngritur një monument të madh për nder të tij. Shumë njerëz besojnë që ai është pjesë e projektit “Shkupi 2014”. Më vonë, partia publikisht ka zbuluar që e kanë vendosur monumentin, pa dhënë informacione se si kanë paguar për të ose kush e ka krijuar (emri i skulptorit mbetet i panjohur). Nuk ka të dhëna nëse monumenti ka ndonjë dokumentacion ligjor apo leje për tu vendosur në vend publik, por është pritur pozitivisht nga shumë qytetarë të Shkupit.

Pyetjet që sugjerohen për diskutim pas shikimit të filmit

1. A duhet të lejohen njerëzit të vendosin monumente në vende publike pa leje të qeverisë?
2. Cilat figura historike duhet të kenë monument në qytetin/fshatin tuaj? A duhet të keni numër të njëjtë të monumenteve nga secila periudhë historike, apo a duhet që për disa periudha historike të ketë më shumë/më pak monumente?

Materiale shtesë për lexim/detyrë shtëpie

1. Hulumtoni së çfarë ka ndodhur me monumentet e Titos pas shpërbërjes së Jugosllavisë me ndihmën e koleksionit të fotografive (MAQ) <http://b2.mk/news/26-jugoslovenski-spomenci-od-idninata?newsid=YvFA>, teksti (SHQ) <http://www.reporter.al/nostalgjia-per-jugosllavine-lulezon-ne-memorialet-e-titos/>, eseu i fotografive (ANG) nga Arna Mačkic <http://www.failedarchitecture.com/mortal-cities-and-forgotten-monuments/>, teksti (ANG/SHQ/BKS) <http://www.kosovotwopointzero.com/article/1011/mbi-monumentet-e-ish-jugosllavise-dhe-int-erpretimin-e-se-kaluares>, dhe teksti (B/K/S) mbi arkitektin jugosllav Bogdan Bogdanoviq http://www.slobodnaevropa.org/content/Bogdanovic_dokumetarni_film/2177961.html
2. Përdorni ushtrimin ‘monumenti im ideal’ (faqe 19) për t’u mundësuar nxënësve që të krijojnë monumentin për liderin të cilin e përzgjedhin.
3. A kanë bërë pjesëmarrësit kërkim për ‘efektin Rashomon’ i cili mirret me interpretime kontradiktore të ngjarjeve të njëjta nga njerëz të ndryshëm. Përdorni artikullin (ANG & B/K/S & SHQ & MAQ) “Jugo-nostalgjia lulëzon tek memorali i Titos” për një hulumtim krahasues. <http://www.balkaninsight.com/en/article/yugo-nostalgia-thrives-at-tito-memorials>

Video e shkurtër 3: Monumentet e Shkupit 2014

Çfarë paraqet monumenti?

Ky film i shkurtër paraqet projektin “Shkupi 2014” i cili plotësisht ka ndryshuar Shkupin si qytet. Projekti përshinë ndërtimin e 34 monumenteve dhe 39 skulpturave tjera të cilat duhet të paraqesin historinë e Maqedonisë dhe “plotësojnë mungesën e artit” në qytet. Pasi që ekziston një numër i madh i monumenteve të cilat janë përfshirë në projekt, filmi e paraqet projektin si të tërë, dhe jo vetëm monumentet specifike. Filmi është i përqendruar në ndikimin e “Shkupit 2014” tek njerëzit që jetojnë në Shkup dhe Maqedoni, sikurse edhe në turistët që vijnë në vizitë.

Çfarë kanë qenë dilemat dhe cilat janë kundërtheniet në lidhje me këtë monument?

Ky film hap pyetjet e transparenës, arsytimit financiar, identitetit dhe të historisë. Njerëzit në Maqedoni janë shumë të ndarë në lidhje me këtë çështje. Një pjesë thotë që kjo është një mënyrë e arsyeshme e shpenzimit të parave publike, gjë që e bënë kryeqytetin e Maqedonisë më terheqës dhe që është i lidhur me historinë e maqedonasve. Për të tjerët, projekti do të thotë shpenzim të një shume të madhe të parave publike (rreth 550 milion € që është 7 herë më shumë se sa është premtuar nga qeveria). Ekzistojnë të dhëna që projekti nuk është bërë në mënyrë të drejtë dhe transparente. Shumë njerëz as që e dijnë se çfarë paraqesin monumentet ose nuk ju pëlqen që pejsazhi i qytetit ka ndryshuar në mënyrë aq drastike.

Pyetjet e sugjeruara për diskutim pas shikimit të filmit të shkurtër

1. Kush duhet të vendos për monumentet të cilët duhet të ndërtohen?
2. Cilat mjete financiare duhen përdorur për monumentet: publike apo private?
3. A janë monumentet një mënyrë efektive për të mësuar historinë dhe “mbushur mungesën e artit”?
4. Cilat ngjarje kyçe historike duhet paraqitur përmes monumenteve?
5. Sllavenka Drakulliq, shkrimtare kroate, një herë ka shkruar (Internationale Politik, shkurt 2011) që vendet e ish jugosllavisë kanë ‘shumë pak histori, tepër shumë kujtime’. Si mund të ketë ‘tepër shumë kujtime’ përmes ndërtimit të monumenteve?

Materiale shtesë për lexim/detyrë shtëpie:

1. Lexoni (ANG/MAQ) mbi “Shkupin 2014” <http://skopje2014.prizma.birn.eu.com> ose lexoni (SHQ) <http://portalb.mk/tag/shkupi-2014/>
2. Pyesni nxënësit se çfarë qëllimi dhe pasojash të gjitha monumente të “Shkupit 2014” mund të kenë. Diskutoni për përgjigjet e mundshme të njerëzve të ndryshëm në qytet (më tepër opinione mund të lexohen (ANG) këtu <http://www.balkaninsight.com/en/article/battle-for-skopje-facades-takes-off>

Si do të reagonit ju?

Dhe nëse nuk pajtoheni, çfarë mundësisht keni si qytetar për të protestuar?

Filmi i shkurtër 1: Monumenti Staro Sajmište

Çfarë paraqet ky monument?

Staro Sajmište – panairi i vjetër i Beogradit/hapësira e tregut është ndërtuar për herë të parë në vitin 1937 në anën e majtë të bregut të lumit Sava në zonën që sot ndodhet në zonën periferike të qendrës së qytetit. Në vitin 1941, territori në të cilin ka qenë panairi/tregu, është bërë pjesë e Shtetit të Pavarur të Kroacisë – NDH dhe është kthyer në kamp përqendrimi për hebrenjë, serbët dhe armiqtë tjerë nga ana nazistëve. Sot ajo është një pjesë e rrënuar e qytetit në të cilin njerëzit jetojnë në banesa ilegale në themele të kazermave të kampit. Edhe përkundër pllakës së vogël në atë vendodhje dhe një monumenti më të madh në brigjet e lumit Sava, nuk ka informacione apo monument i cili ndodhet brenda hapësirës së kampit.

Cila kanë qenë dilemat apo kundëthëniet në lidhje me këtë monument?

Gjatë luftës së dytë botërore, lokacioni i kampit të përqendrimit ka qenë mu pranë kryeqytetit dhe 'furgonat me gas' ndonjëherë kanë kaluar nëpër qytet. Kjo ka shtruar pyetje lidhur me njohuritë të cilat njerëzit në qendër të qytetit kanë patur për kampin. Pas luftës, njerëzit të cilët kanë pësuar dhe humbur jetën në kampin Staro Sajmište (kampi hebrenj në Zemun) asnjëherë nuk kanë qenë të përkujtuar siç duhet. Në ditët tona, nuk ka shumë qytetarë të Beogradit të cilët e dinë historinë e këtij vendi dhe pa ndonjë ciceron tregimi i kampit lehtë mund të anashkalohej kur të vizitohet kjo pjesë e qytetit.

Pyetjet e sugjeruara për diskutim pas shikimit të filmit të shkurtër

1. Duke marrë parasysh rrethanat, a mendoni që njerëzit e Beogradit e kanë ditur se çfarë ka ngjarë në atë kohë? Çfarë, sipas mendimit tuaj, motivon njerëzit që të (mos) reagojnë në këso rrethanash? A do të reagonit nëse diçka e ngjashme do të ndodhte sot?
2. Përse nazistët i kanë ndërtuar kampet e tyre zakonisht në zona të izoluara, larg nga pjesa tjetër e popullsisë?
3. A e dini ndonjë vend të ngjashëm në qytetin/rajonin tuaj?
4. A mendoni që Staro Sajmište duhet të përkujtohet në ndonjë mënyrë tjetër dhe nëse po si?
5. Shumica e ish kampeve të përqendrimit janë kthyer në qendra memoriale apo muze. Përse mendoni që kjo nuk ka ndodhur me Staro Sajmište në Beograd? Çfarë mendoni për jetesën në shtëpi të cilan qëndrojnë në vendin e ish kazermave të kampit të përqendrimit?

Materiale shtesë për lexim/detyrë shtëpie

1. Lexoni (ANG/BKS) më tepër informacione për Staro Sajmište <http://www.starosajmiste.info/sr/> dhe krahasoni përdorimin e tanishëm të hapësirës së kampit me atë të kampit tranzit të luftë së dytë botërore në Drancy, Francë, i cili gjithashtu është në përdorim si projekt i strehimit social.
2. Shikoni (ANG/BKS) filmin dokumentar i cili e tregon Staro Sajmište <https://www.behance.net/gallery/821870/Staro-Sajmiste-documentary-series>
3. Lexoni (ANG) “My good father” nga Beate Niemann e cila ka shkruar për babain e saj, kreun e Gestapos në Beograd.
4. Lexoni (ANG/BKS) për Hilda Deutsch, informiere vullnetare i cila i ka ndihmuar të burgosurit në Staro Sajmište dhe më tepër për persekutimin e hebrenjëve në Serbi: http://joz.rs/Sajmiste/Catalog_Sajmiste_ĚEB.pdf
5. Lexoni(B/K/S) pjesë nga Jovan Bajford “STARO SAJMIŠTE Mesto sećanja, zaborava i sporenja” (2011) https://rs.boell.org/sites/default/files/staro_sajmiste_-_jovan_bajford_72_dpi.pdf & lexoni (ANG) Rena Jeremić Rwdle “Remembrance in Transition: The Sajmište Concentration Camp in the Official Politics of Memory of Yugoslavia and Serbia” <http://www.cultures-of-history.uni-jena.de/debating-20th-century-history/serbia/remembrance-in-transition-the-sajmiste-concentration-camp-in-the-official-politics-of-memory-of-yugoslavia-and-serbia/>
6. Hulumtoni grupet e ndryshme të persektuara të cilat ektistojnë sot.



Filmi i shkurtër 2: Obelisku i Lëvizjes së të painkuadruarve

Çfarë paraqet ky monument?

Obelisku është ndërtuar në vitin 1961 me qëllim që të theksohet rëndësia e konferencës së parë të Lëvizjes së të painkuadruarve, e cila është mbajtur në Beograd. Gjatë kësaj konference, 25 vende kanë aprovuar deklaratën që të mos zgjedhin njërin nga dy aleancat më të mëdha ushtarake gjatë luftës së ftohtë. Në vend të kësaj Lëvizja e të painkuadruarve ka zgjedhur strategjinë e 'ekzistencës paqësore'. I vendosur në anën e djathtë të lumit Sava, ky është njëri prej monumenteve për të cilin njerëzit dinjë shumë pak. Bile edhe krijuesi i tij i vërtetë ende mbetet misterioz duke patur shumë pretendime mbi atë së kush në të vërtetë e ka krijuar monumentin?

Cilat kanë qenë dilemat apo cilat janë kundërthëniet që kanë të bëjnë me këtë monument?

Për shkak të dukjes së tij – obelisku i hollë i bardhë me simbolin e vetëm simbolin e qytetit të Beogradit – shumë njerëz nuk janë të vetëdijshëm që në fakt ky monument i dedikohet një konference ndërkombëtare. Në këto kohë, monumenti dhunohet rregullisht.

Pyetjet e sugjeruara për diskutim pas shikimit të filmit të shkurtër

1. Përse është krijuar Lëvizja e të painkuadruarve?
2. Në përpjekjet e dy palëve për supremaci, cili mund të jetë roli i palës së tretë neutrale?
3. Cila mund të jetë arsyeja për shkak të së cilët monumenti nuk është mirëmbajtur për aq shumë kohë?
4. A ekziston dallimi tek vendosja e monumentit të një ngjarje historike të kohës së paqes në krahasim me një monument i cili përkujton luftën apo konfliktin?
5. A ju përkujton ky monument në mënyrë adekuate kalimtarëve atë çfarë ai paraqet?

Materiale shtesë për lexim/detyrë shtëpie

1. Shikoni (ANG) serinë e filmave dokumentar të CNN: "Cold War"
<http://www.cnn.com/2014/01/02/world/the-cold-war-landmark-documentary/>
2. Hulumtoni rolin e organizatave kryesore ndërkombëtare gjatë Luftë së ftohtë.
3. Kërkoni të dhëna për Lëvizjen e të painkuadruarve në të kaluarën dhe tanishëm.

Filmi i shkurtër 3: Monumenti Përse/Zašto?

Çfarë paraqet ky monument?

I ndërtuar në vitin 2012, ky monument përkujton viktimat e bombardimit të ndërtesës së RTS (Televizion kombëtar serb) në vitin 1999 nga forcat ajrore të NATO si përgjigje për luftën në Kosovë. Në monument ndodhet lista e emrave të (numri?) njerëzve të cilët janë vrarë gjatë bombardimit dhe sipër tij mund të shihet fjala "Përse?". Monumenti është vendosur në parkun e njohur Tashmajdan sipër ish ndërtesës së RTS.

Cilat kanë qenë dilemat apo cilat janë polemikat në lidhje me këtë monument?

Polemika kryesore në lidhje me monumentin në Serbi ka të bëjë me legjimitetin e bombardimeve të caqeve kyqe të NATO-së në Serbi si përgjigje për përgjegjësitë e tyre gjatë luftës në Kosovë, që ende vazhdon të vihet në pikëpyetje. Ky sulm konkret në ndërtesën e RTS kontestohet në kuptimin e trajtimit të medimeve si caqe legjitime ushtarake në konfliktet ndërkombëtare. Edhe pse është e pranuar, bile edhe në Serbi, që televizioni nacional serb ka qenë vegël propagandistike e regjimit të Sllobodan Millosheviqit, ekziston dilema nëse ky ka qenë cak legjitim për NATO-në për ta bombarduar. Ekzistojnë kontroversa në Serbi përse i përket pretendimeve të konfirmuara që zyrtarët shtetëror (përfshirë edhe kryeredaktorin e RTS) e kanë ditur për sulmin i cili do të pasonte dhe nuk kanë pranuar të evakujnë ndërtesën për qëllim të përdorimit të viktimave civile për propagandë.

Pyetjet e sugjeruara për diskutim pas shikimit të filmave të shkurtër

1. Çfarë ndikimi mund të kenë mediat gjatë luftës?
2. Cili është dallimi në mes të lajmit dhe propagandës?
3. Cilat palë ndajnë përgjegjësinë për vdekjen e punonjësve të mediumit në këtë rast? Dhe përse është kjo me rëndësi që njerëzit ta dijnë?
4. Përse njerëzit shmangin të përmendin regjimin e Sllobodan Millosheviqit gjatë filmit të shkurtër?
5. Përse nuk përmenden viktimat në Kosovë në monumente dhe gjatë ceremonive përkujtimore?

Materiale shtesë për lexim/detyrë shtëpie

1. Lexoni (ANG/ BKS) një shkrim me opinion për bombardimet e NATO-së "29 April 1999" nga Snježana Milivojević <http://pescanik.net/29-april-1999/> dhe lexoni (B/K/S) <http://pescanik.net/bombardovanje-za-pocetnike>
2. Lexoni (ANG) në lidhje me zhvillimet e fundit përse i përket bombardimit të RTS: www.balkaninsight.com/en/article/state-commission-to-investigate-nato-killed-journalists
3. Hulumtoni për fatin e gazetarëve tjerë që kanë raportuar nga zonat e luftës apo për historinë e ndërtesave të institucioneve tjera mediatike gjatë luftës (siç është ndërtesa e gazetës 'Oslobodjenje' në Sarajevë, Bosnje-Hercegovinë).

Biblioteka Memory Walk

Fusha e studimeve të trashëgimisë dhe kujtimeve ka lulëzuar në njezët vitet e fundit, duke ofruar mundësi të shumta për të hulumtuar monumentet ekzistuese dhe për të lexuar për vështirësitë në përkujtimin e së kaluarës. Më poshtë mund të gjeni disa të dhëna të cilat janë drejtpërdrejt të lidhura me projektin e Memory Walk, disa faqe interneti të cilat do të ju ndihmojnë që të hulumtoni hapësira të ndryshme memoriale dhe një përzgjedhje të materialeve mbështetës. Ato përmbajnë referenca për gjuhët në të cilat janë (ANG & B/K/S & MAQ&SHQ).

Burimet Memory Walk

Faqja e internetit të HIP, e cila përmban material shtesë dhe detajet e kontaktit të koordinatoreve lokal.

www.historijaistorijapovijest.org

Kanali në Youtube i Memory Walk Anne Frank House

<https://www.youtube.com/playlist?list=PL508euqE77BrQsm-DVyAZDZcBQUq4laqb>

Faqja e internetit e Memory Walk

<http://www.annefrank.org/en/Education/Special-Projects/Memory-walk/>

Boerhout, Laura dhe Barry van Driel. 2013. "Memory Walk: An Interaction-Oriented Project to Interrogate Contested Histories." *Intercultural Education* 24: 211-221.

Klacsman, Borbála, "Memory Walk: History through Monuments" in: Andrea Peto and Helga Thorson, *The Future of Holocaust Memorialization: Confronting Racism, Antisemitism, and Homophobia through Memory Work* Tom Lantos Institute, 2015.

<http://tomlantosinstitute.hu/content/future-holocaust-memorialization-confronting-racism-antisemitism-and-homophobia-through>

Burimet mbi memorializimin (të përgjithshme) - (të gjitha ANG)

Ashplant, Timothy G., Graham Dawson and Michael Roper (eds.).

Commemorating War. The politics of memory (London: Transaction Publishers, 2004).

Stig Sorensen, Marie Louis and Dacia Viejo Rose (eds.)

War and Cultural Heritage. Biographies of Place (Cambridge: Cambridge University Press 2015).

Vree, Frank van, "The Art of Commemoration and the Politics of Memory" Open 2004/Nr.

7/(No)Memory

http://www.skor.nl/_files/Files/OPEN7_P16-33.pdf

Winter, J., and E. Sivan (eds.), *War and remembrance in the twentieth century*

(Cambridge: Cambridge University Press 2000).

Vendet ndërkombëtare të ndërgjegjes

Koalicioni ndërkombëtar i vendeve të ndërgjegjes është një rrjet botëror i përkushtuar në transformimin e vendeve të cilat ruajnë të kaluarën në hapësira dinamike të cilat promovojnë veprimin qytetar në përpjekjet e sotme për të drejtat e njeriut dhe drejtësi. Faqja e saj e internetit ofron informacione mbi hapësirat memoriale në tërë botën.

<http://www.sitesofconscience.org/> & <http://www.youtube.com/user/SitesofConscience>

Laboratori i kujtesës

Lobaratori i kujtesës ofron platformë për shkëmbim, bashkëpunim dhe të kuptuarit kritik të historisë dhe kujtesës në Europë. Ai lidh institucione, organizata dhe persona të cilët punojnë në hapësira memoriale dhe të mësuarit e kujtesës në Ballkanin përendimor dhe në Europën përendimore.

Faqja e tij e internetit ofron informacione mbështetëse për qendrat memoriale në Europë.

<http://www.memorylab-europe.eu/index.html>

Burimet e memorializimit (rajonale)

Banjeglav, Tamara “A Storm of Memory in Post-War Croatia”

Cultures of History University of Jena 2015 (ENG)

<http://www.cultures-of-history.uni-jena.de/debating-20th-century-history/croatia/a-storm-of-memory-in-post-war-croatia/>

Karačić, Darko, Tamara Banjeglav Nataša Govedarica, RE:VIZIJA PROŠLOSTI Politike sjećanja u Bosni i Hercegovini, Hrvatskoj i Srbiji od 1990. Godine 2012 (B/C/S)

<http://library.fes.de/pdf-files/bueros/sarajevo/09702.pdf>

Moll, Nicolas ‘Interview: A Different Kind of Remembrance’

Balkan Insight 2013 (ANG & B/K/S &SHQ& MAQ)

<http://www.balkaninsight.com/en/article/a-different-kind-of-remembrance>

Moll, Nicolas ‘Division and denial and nothing else? Culture of history and memory politics in Bosnia and Herzegovina’ *Cultures of History* 2015 (ANG)

<http://www.cultures-of-history.uni-jena.de/debating-20th-century-history/bosnia-and-herzegovina/division-and-denial-and-nothing-else-culture-of-history-and-memory-politics-in-bosnia-and-herzegovina/>

Moll, Nicolas “Sarajevska najpoznatija javna tajna”: Suočavanje sa Cacom, Kazanima i zločinima počinjenim nad Srbima u opkoljenom Sarajevu, od rata do 2015. (“Sarajevo’s most known public secret”: Dealing with Caco, Kazani and crimes committed against Serbs in besieged Sarajevo, from the war until 2015) *Friedrich Ebert Foundation BiH, Sarajevo, 2015* (B/K/S)

http://www.fes.ba/files/fes/pdf/publikationen/2014/2015/Moll_Final_Web_Version.pdf

Ristić, Marija “Yugo-Nostalgia Thrives at Tito Memorials”

Balkan Insight 2013 (ANG & B/K/S &SHQ & MAQ)

<http://www.balkaninsight.com/en/article/yugo-nostalgia-thrives-at-tito-memorials>

CDRSEE Joint History Project (ANG & B/K/S & MAQ&SHQ)

TEACHING MODERN SOUTHEAST EUROPEAN HISTORY

Materialet alternative edukative të Qendrës për demokraci dhe pajtim në Europën Juglindore, siç është Libri 4 “Lufta e dytë botërore”

<http://cdrsee.org/projects/jhp/publications>

EUROCLIO HIP-BiH (ANG & B/K/S)

Materiali arsimor i historisë alternative, siç janë

“Njerëzit e thjeshtë në një vend të posaçëm” në periudhën e Jugosllavisë.

<http://cliohipbih.ba/materijali/topic/ordinary-people/>

Portali online 'Kujtimet kundërthënëse. Monumentet postkonfliktuale të Ballkanit në fokus' (ANG & B/K/S & MAQ&SHQ)

Ky portal lajmesh nga Balkan Insight përfshinë një hartë me një numër monumentesh në rajon dhe të dhënat mbështetëse.

www.balkaninsight.com/en/page/balkan-transitional-justice-memorialisation-conflicting-memories

MONUMENTI – fytyra e ndryshueshme e Kujtesës në Ballkanin Përendimor (ANG & B/K/S)

Katalog nga *forumZFD* me fotografi të monumenteve nga rajoni nga Marko Krojaç dhe kontribut të: Christian Pfeifer (Drejtesit rajonal të *forumZFD*); Dr Lutz Schrader: Monumentet dhe politika e identitetit në Ballkanin Përendimor; Dr Bojana Pejić: Monumentet jugosllave: Arti dhe retorika e fuqisë; Mirjana Peitler-Selakov: Arti memorial në Serbi nga luftat ballkanike deri më sot; Dr. Senadin Musabegović: Rëndësia simbolike e monumenteve në Bosnje dhe Hercegovinë; Dr. Vjeran Pavlaković: Historitë e kontestuara dhe të kaluarat monumentale: Kultura kroate e përkujtimit; Shkëlzen Maliqi: Lufta e simboleve: Kujtesa në Kosovë; Valentino Dimitrovski: Kthimi në të kaluar: Monumentet dhe kujtesa në Maqedoni.

<http://westernbalkans.forumzfd.org>

MemorInmotion. Vegël pedagogjike për kulturën e kujtesës (ANG & B/K/S)

Në partneritet me Shoqatën e Mësimdhënësve të Historisë në Bosnje dhe Hercegovinë (EUROCLIO HIP BiH), Iniciativa e të rinjve për të drejtat e njeriut (YIHR-BiH), Humanizmi në veprim Bosnje dhe Hercegovinë, dhe Anne Frank House, *forumZFD* në Bosnje and Hercegovinë kanë zhvilluar dhe zbatuar trajnimin për trajnuesit e ardhshëm të veglës pedagogjike "MemorInmotion", e cila ka për qëllim promovimin e kulturës së kujtesës dhe brenda saj edhe rolin të monumenteve.

<http://westernbalkans.forumzfd.org/en/activity/lessons-past-tools-future>

Pasqyra e monumenteve jugosllave (ANG & B/K/S & MAQ)

Faqe interneti me fotografi të monumenteve nga Jugosllavia, versioni në B/K/S:

<http://www.6yka.com/novost/36781/ovi-jugoslovenski-spomениci-izgledaju-kao-da-su-sa-druge-planete-foto>

Faqja e internetit të ballafaqimi me të kaluarën në Ballkan (ANG & B/K/S & MAQ & SHQ)

Portali online me artikuj që merren me të kaluarën në rajon.

<http://www.dwp-balkan.org/en/>

Faqja e internetit së Monumenteve të papërshtatshme (ANG & B/K/S)

Baza e të dhënave në internet me monumente të cilat merren me rivlerësimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë antifashiste të Jugosllavisë dhe të trashëgimisë së monumenteve që merren me Luftën popullore çlirimtare.

<http://inappropriate monuments.org/en/>

Falenderimet

Koordinatorët:

Laura Boerhout (Anne Frank House / Universiteti i Amsterdamit),
Dr. Maja Nenadović (Anne Frank House)

Kontribuesit:

Rodoljub Jovanović (University of Amsterdam)
Boris Miković (Open Communications),
Tvrтко Pater (HERMES),
Wouter Reitsema (history teacher / Anne Frank House),
Sanja Stefanović (Youth Educational Forum)

Recensionet:

Barry van Driel (Shoqata ndërkombëtare për arsim ndërkulturor),
Ivana Gabalova (Anne Frank House),
Senada Jusić (mësuese e historisë / EUROCLIO HiP-BiH),
Ida Ljubić (mësuese e historisë),
Dr. Nicolas Moll (hulumtues i pavarur)

Të drejtat autoriale, fotografitë:

Kerim Somun (YIHR BiH),
Vedran Senjanović (regjisor),
Gema Arrieta Domingo (Anne Frank House),
Inga Kotlo (përkthyes e pavarur),
Marko Matović (pjesëmarrës në Memory Walk)

Përkthimi dhe lektorimi:

Bashkim Fazliu, Mitre Georgiev, Rodoljub Jovanović, Inga Kotlo, Mirela Nenadović
Orhan Ceka, Helena Roštaš, Ibro Sakić, Sanja Stefanović

Dukja dhe dizajni:

Rodoljub Jovanović (University of Amsterdam), Ines Lambert

Dizajni i llogos:

Erica Terpstra (Anne Frank House), Overhaus

Shtypja:

Knjigoprint Zagreb

Falenderimet

Ky doracak dhe DVD përcjellëse nuk do të ishin të mundshme pa përkrahjen e Bashkimit Europian për projektin 'Historija, Istorija, Povijest – Mësimet për të sotmen.' I financuar sipas skemës së granteve EuropeAid/135428/DH/ACT/MULTI, "Pajtimi në Ballkanin Përendimor përmes analizës së të kaluarës jo të largët, raportimit mbi drejtësisë tranzicionale dhe avancimit të gazetarisë hulumtuese", përmes këtij granti gjithashtu janë përkrahur punëtoritë kreative të Memory Walk gjatë së cilave janë krijuar filmat e shkurtër në Bosnje e Hercegovinë, Kroaci, Serbi dhe Maqedoni. Punëtorja Memory Walk në Bosnje dhe Hercegovinë (2013) është financuar nga Humanity in Action, ambasada gjermane në BeH, ambasada austriake në BeH, ambasada italiane në BeH dhe Vullnetarët e Kombeve të Bashkuara.

Shprehim falenderimet tona për të gjithë pjesëmarrësit, mësimdhënësit, redaktorët e filmimit dhe ekspertët të cilët kanë kontribuar në punëtoritë e Memory Walk dhe që kanë ndihmuar në konceptualizimin e ushtrimeve të cilat mund t'i gjeni në këtë doracak.

Ky doracak është i krijuar në bazë të dy doracakëve të mëhershëm të cilët janë krijuar në dy vitet e fundit: *Memory Walk. Udhëzuesi edukativ* (nga Kongresi i pakicave kombëtare të Ukrainës) & *Memory Walk. Udhëzuesi edukativ* (nga Kongresi i pakicave kombëtare të Ukrainës) & *Memory Walk. Udhëzuesi edukativ* (nga Kongresi i pakicave kombëtare të Ukrainës).

Dëshirojmë në mënyrë të posaçme t'i falenderojmë ekspertët e këtyre doracakëve:

Kira Kreyderman (Kongresi i pakicave kombëtare të Ukrainës),

Olexander Voitenko (ekspert i pavarur),

Mikhail Tyaglyy (Qendra ukrainase për studime të holokaustit),

Michele Parente (*forumZFD*),

Dr. Larisa Kasumagić-Kafedžić (Universiteti Sarajevës),

Senada Jusić, Bojana Dujković-Blagojević, Melisa Forić (EUROCLIO HiP-BiH),

Muhamed Kafedžić-Muha (regjisor),

Marko Krojač (fotograf),

Dr. Nicolas Moll (hulumtues i pavarur) dhe

Barry van Driel (Anne Frank House).

*“Më nuk do të eci pranë një monumenti
pa e parë atë dhe pa e lexuar pllakën në të.”*

citim nga një pjesëmarrës/se i/e Memory Walk Zagreb

*“Vlerësoj më tepër, ndihem më i përfshirë dhe më i interesuar
në tregimet që qëndrojnë pas monumenteve aktuale”*

citim nga një pjesëmarrës/se i/e Memory Walk Beograd



*“Kam mësuar të shikoj me thellë në
mesazhet që fshihen pas monumenteve.”*

citim nga një pjesëmarrës/se i/e Memory Walk në Bosnje

“Përvojë që më ka ndryshuar jetën”

citim nga një pjesëmarrës/se i/e Memory Walk Shkup

Në bashkëpunim me:

anne frank house

Partnerët e projektit:



Open Communication



**HUMANITY IN
ACTION**
Bosnia and Herzegovina



МЛАДИНСКИ
ОБРАЗОВЕН
ФОРУМ
YOUTH
EDUCATIONAL
FORUM

Ky projekt është i financuar nga Bashkimi Europian. Qëndrimet dhe përbajtja e këtij botimi janë përgjegjësi vetëm e autorëve dhe se nuk reflektojnë qëndrimet e Bashkimit Europian.